

*Shënime mbi
aktivizmin e grave
dhe politikën feministe
në pas-Jugosllavi*

VJOLLCA KRASNIQI DHE JELENA PETROVIQ



PËRMBAJTJA

- 5 *Gratë në të kaluarën, në kohë dhe në hapësirë, Dubravka Stojanović*
- 17 SHËNIME MBI AKTIVIZMIN E GRAVE DHE POLITIKËN FEMINISTE NË PAS-JUGOSLLAVI, VJOLLCA KRASNIQI DHE JELENA PETROVIQ
- 18 *Hyrje: Çështja politike është personale*
- 22 *Fjalori i (pa)mundshëm pacifist/aktivist dhe feminist*
- 26 *Çfarë mbeti nga e majta feministe?*
- 41 *Çfarë nënkupton lufta sot?*
- 48 *Çfarë është kuptimi i lirisë?*
- 50 *Çfarë do të thotë aktivizmi i grave? Midis praktikës kolektive dhe punës individuale*
- 52 *Gratë e Ballkanit për Paqe: Aktivistet i kalojnë kufijtë*
- 59 *Gjykata e Grave për ish-Jugosllavi: Kërkimi i drejtësisë, të vërtetat dhe kujtesa aktive*
- 65 *Edhe një rrëfim për gratë në Kosovë në socializëm: Zona e hirtë midis*
- 67 *Arti si aktivizëm: Puna individuale e artisteve në Kosovë dhe në Serbi*
- 72 *Narratizimi i aktivizmit të grave në Kosovë dhe në Serbi*
- 83 *Shënim përfundimtar për ardhmërinë e përbashkët emancipuese*
- 93 BIBLIOGRAFIA
- 100 BIOGRAFI TË SHKURTRA TË AUTORËVE
- IMPRESUM

Shënime mbi aktivizmin e grave dhe politikën feministe në pas-Jugosllavi

*Vjollca Krasniqi
dhe Jelena Petroviq*

*Fondazioni
Jelena Shantiq*

*Gratë në të kaluarën,
në kohë dhe në hapësirë*

Dubravka Stojanović

Çështja e grave është çështje politike. Kështu do të mund të ishte parafraza e parafrazës së slloganit të njohur nga viti¹ me të cilin Vjollca Krasniqi dhe Jelena Petroviq fillojnë studimin hyrës të librit *Notes on Post-Yugoslav Women's Activism and Feminist Politics*. Kjo nënkupton se çështje e grave gjithnjë ka qenë çështje politike, por që edhe të gjitha çështjet e tjera politike gjithnjë janë shndërruar në çështjen e pozitës së grave. Dhe edhe njëherë, edhe tjetër, edhe atë politike edhe ate të grave , i shohim dhe i kuptojmë më mirë kur i gërshetojmë, kur i shikojmë në simbiozë.

Çështje e grave ka shkuar krahas çështjes politike. Që kur në shek. XIX për herë të parë është shtruar çështja e grave, ajo gjithnjë ka qenë e lidhur me çështjet e tjera të afërta “simot-ra”. Së pari, është lidhur me idenë e socializmit, sepse besohej se çlirimi klasor domosdosmërisht do t’ua sjellë lirinë grave. Diçka e ngjashme besohej edhe në rastin kur e shihnim në lidhje me idenë e nacionalizmit në shekullin

¹ “Personalisht është politike“, përkatësisht “ Politikisht është personale“.

XIX - që kombi i lirë ua sjell lirinë 7
edhe grave. Edhe lëvizja e dekolonizimit vuri vulën e fuqishme, bashkë me bindjen se gratë do të çlirohen duke u çliruar nga metropoli. Edhe liberalizmi duke u përqendruar në individin e lirë premtoi në programin e vet edhe individin e lirë. Edhe demokracia me parimin e përgjithshëm, pra edhe të së drejtës së votës për gratë, u duk si aleancë e mirë. Lidhjet politike midis këtyre ideologjive dhe lëvizjes së grave kanë qenë të qarta, por në tërë këtë çështja e grave mbetet si lidhëse, në mënyrë të tillë që diçka do të dalë nga format e tjera të lirisë, të cilat janë më të vjetra, më të rëndësishme, të cilat kanë më shumë përparësi. Më vonë feminizmi nga vitet e 60-ta filloi ta përmbysë një rend të tillë të vendosur të gjërave dhe të bëjë qartazi me dije se pa liri të grave nuk ka as liri të shoqërisë, as klasa, as kombe. Por as burra.

Tema e këtij libri veçanërisht është e rëndësishme edhe për vetë faktin se çështja e grave gjithnjë ka qenë edhe pacifiste. Kjo, natyrisht, nuk do të thotë se të gjitha gratë kanë qenë

paqësore, por domethënë se të gjitha lëvizjet paqësore kanë qenë të grave. Dhe këtë e shohim që nga institucionet e para të grave nga vitet e 80-ta të shekullit XIX, nga të cilat, me nismën e pacifistes austriake Berte fon Sutner, që nga viti 1901, është vendosur Çmimi Nobël për Paqe. Që në fillim të Luftës së Parë Botërore janë krijuar edhe organizatat e para të grave, të cilat kanë qenë kundër luftës. Pacifistet e 12 shteteve janë grumbulluar në Hagë në vitin 1915 dhe e kanë themeluar Lidhjen e Grave për Paqe dhe Liri. E gjithë kjo duhet kuptuar edhe si pjesë e lëvizjeve të para kundër luftës në përgjithësi, sepse gjithnjë deri te Lufta e Parë Botërore u përjetua si sfidë maksimale, ku në rivalitetin fisnor do të tregohen ata që janë më të mirët. Përmbysja në të cilin ka rënë qytetërimi duke rënë në llogore balte të fronteve perëndimore dhe fronteve të tjera u ka dhënë impuls pikërisht grave që të thonë se nuk e pranojnë më një gjë të tillë.

Nëse ky do të ishte kontekst mjaft i shkurtuar, i cili na nevojitet që ta kuptojmë për çfarë na flasin aktivis-

tet në intervista në të cilat bazohet 9
ky libër. Në këto intervista tetë gra
flasën për aktivizmin e vet politik
dhe artistik kundër luftës, angazhim
në të cilin gjatë viteve të 90-ta i
kanë kundërshtuar luftërat që i kanë
zhvilluar udhëheqësit e tyre kombë-
tarë në ish-Jugosllavi, veçanërisht në
Serbi dhe në Kosovë. Prandaj pyetje
kryesore është si të kuptohet feminiz-
mi jugosllav kundër luftës dhe gjendet
ku e ka pozicionin politik?

Është e sigurt se që nga fillimi në
vitet e 70-ta feminizmi në Jugoslla-
vinë socialist gjithnjë ka qenë disi-
dent, sepse ka qenë kritik ndaj mëny-
rës sipas së cilës marksizmi ka qenë
i verbër për shfrytëzimin e grave, si
lloj i veçantë i varësisë. Mirëpo, fe-
minizmi jugosllav ka pasur edhe disa
dallime të rëndësishme në krahasim me
feminizmat të cilët kanë lindur në
pjesët e tjera të botës që nga fundi
i viteve 60'. Në dallim nga feminizmi
në Lindje, i cili nuk ka qenë kri-
tik ndaj Perëndimit dhe kapitalizmit,
feminizmi jugosllav, përkundrazi, ka
qenë kritik. Bashkë me këtë, femi-
nizmi jugosllav ka qenë kritik edhe

ndaj pjesës më të madhe të disidentëve të vendit, të cilët kryesisht e kanë kritikuar komunizmin, të djathtët, si tradicionalistë, kombëtarë dhe patriarkalë edhe më agresivë ndaj çështjes së grave se sa kanë qenë të tillë pushtetet socialiste. Dhe pikërisht për shkak të tërë asaj që fituan gratë në socializmin jugosllav, ato, në dallim nga ato në Perëndim dhe ato në Lindje, nuk kanë qenë nën shtypjen e plotë të shtetit, pikërisht të vetëdijshëm se alternativa nuk u sjell robërim edhe më të madh. Kështu feministet jugosllave e morën rrugën e vet, duke i ndarë idetë dhe lëvizjet e veta nga ciliado rryma politike, qeverisëse ose opozitare, duke bërë kështu precedencë në historinë e përgjithshme të lëvizjeve të grave, të cilat zakonisht kanë kërkuar “hapësirë më të gjerë” të ideve politike vëllazërore. Feministet jugosllave e kanë shprehur atë që nuk kishte guxim ta artikulonte askush, kështu dëshmon Svetlana Slapshak në intervistën që dha për këtë hulumtim.

Në një rrugë mjaft të vetmuar u nisën feministet jugosllave veçanërisht në fillim të luftërave në ish-Jugosllavi.

Gratë në të kaluarën, në kohë dhe në hapësirë

Krejtësisht të harmonizuara me paraar- 11
dhëset e veta pacifiste, ato padyshim
u ngritën kundër luftës, duke organi-
zuar aksionet, organizatat, lëvizjet
e para artistike dhe politike kundër
luftës. Ky hulumtim flet për këto rrë-
fime. Dhe të gjitha këto rrëfime e
kanë fillimin të vështirë. Këtë rrëfim
e përbëjnë vlerat e përbashkëta, të
cilat ua dhanë forcën dhe inkurajimin
që të kundërshtojnë, të kërkojnë
paden në situata në të cilat njësitë
e shfrenuara ushtarake, policore dhe
paramilitare shkatërrojnë, u vunë zjar-
rin shtëpive, vranë dhe përdhunuan me
radhë. Dhe pikërisht në një situatë
të këtillë, në të cilën kryengritja
ishte e rrezikshme dhe për jetë në të
cilën pikërisht përdhunimi ishte një
nga mjetet më të adhuruara luftara-
ke, gratë jugosllave, u bashkuan, dhe
klithën: “Majft më“!

Krahas të gjitha shkaqeve historike
dhe politike për këtë i detyroi diçka
që në shikim të parë duket mjaft e th-
jeshtë. Siç dëshmon Svetlana Slapshak
në këtë hulumtim, ato çdo ditë është
dashur të mendojnë për gratë e tjera,
24 orë në ditë. Brenga për gratë në

Vukovar, Dubrovnik, Sarajevë, Prijedor, Mostar, Prishtinë, Beograd... Ish-te imupls i parë i cili i nxiti. Sado që kjo tingëllon si gjë minimaliste, pikërisht kjo është brenga për “tjet-rin“, për tjetrën, ajo që thellësisht e rrënon brendinë e nacionalizmit, i cili kujdeset vetëm për vete, kur te të tjerët e sheh rrezikun dhe armikun. Kurse të brengosesh, të mendosh, të kujdesesh për dikë, të ndiesh dhembje - tërë kjo e rrënon logjikën themelore të luftës. Sepse, lufta bazohet në idenë që armiku nuk mund të jetë njeri dhe, edhe më pak - gruaja.

Lëvizja feministe kundër luftës mbeti jugosllave, siç thonë në hyrje Vjoll-ca dhe Jelena. Pikërisht për shkak të kësaj që ajo, siç thotë në intervistë Jelena Vishnjiq, sipas brendisë së vet e nënkuptoi tejkalimin e kufijve, edhe kufijve personalë, edhe atyre parti-akë. Në luftën e të gjithëve kundër të gjitha feministeve jugosllave u kth-yen ndaj „të vetëve“. Por, ndaj kom-bit të vet, i cili e paraqet veten si viktimë, përderisa e drejton gishtin te krimet e të tjerëve, por përkund-razi: feministet e drejtojnë gishtin

ndaj krimeve të anës “së vet“, ndaj 13
përgjegjësisë “së të vetëve“ , siç
dëshmon Lepa Mlagjenović nga përvoja e
vet kundër luftës dhe përvoja e Grave
me të Zeza. Kjo është në kundërshtim
me logjikën e luftës dhe të idhujve
të tyre. Të shohësh veten në mënyrë
kritike dhe të kujdesesh për tjetrin
është krejt e kundërt me logjikën e
cila bazohet në krim.

Në fund, në studimin e Jelenës dhe të
Vjollcës dhe në të gjitha intervistat
shtrohet pyetja ku është sot feminizmi
kundër luftës? Ku është sot çështja e
grave në hapësirën e dikurshme dhe në
atë kohë të shkuar në të cilën jemi
ende duke jetuar? Përgjigjja për këtë
çështje varet nga ajo se si e shohim
gjendjen në shtetet e sotme. Sepse,
siç përkufizohet në studim, jetojmë në
një luftë të vazhdueshme globale, në
një situatë në të cilën nuk ekzistojnë
më dallime midis luftës dhe paqes, gjë
që, siç mendojnë autoret, është kor-
nizë themelore e studimit hyrës. Ose,
ndoshta më saktë, ashtu siç e përkufi-
zon këtë gjendje Svetlana Slapshak
në intervistën e vet – si gjendje e
fashizmit të ardhshëm.

Në këtë situatë feminizmi ka për detyrë që të luftojë për emancipimin duke i rikujtuar vazhdimisht krimet e bëra si “ground zero“, si “çështje e të gjitha çështjeve“. Sepse, pa pasur përgjigje në lidhje me këtë pyetje, nuk mund të shkohet më tutje. Feminizmi ka për detyrë që vazhdimisht të rishqyrtojë dhe të kërkojë përgjigje aktiviste dhe artistike që mund ta parandalojnë të keqen e re, gjë për të cilën apelojnë në intervistat e veta Zana Hoxha Krasniqi, Blerta Zeqiri dhe Aleksandra Sekuliq. Edhe në studim, edhe në intervista, veçanërisht te Olga Dimitrijeviq, shtrohet vetvetiu pyetja dhe çështja, a është sot feminizmi i domosdoshëm, apo ai është kështu vetëm për të majtën dhe a është, pra, përsëri i lidhur me një lëvizje të gjerë me të cilën duhet të luftohet për ndryshimet shoqërore? Ose ndoshta tashmë ka forcë që të fillojë përsëri vetë, duke u mbështetur pikërisht në përvojën e vet të luftës, të cilën refuzoi ta quante etno-nacionalizëm dhe mbeti jugosllav, aktivist dhe kundër luftës? Dhe deri tani, në këtë gjendje as të luftës as të paqes, jashtë hapësirës dhe kohës, përsëri pa alean-

cë, po e zhvillon betejën për shoqëri 15
të barabartë, të drejtë dhe humane,
siç thuhet në fjalinë përfundimtare të
studimit? Ndoshta ka forcë që nga lë-
vizja të cilën e përdor si udhëheqëse,
tani të bëhet udhëheqëse.

Shënime mbi aktivizmin
e grave dhe politikën
feministe në
pas-Jugosllavi

*Vjollca Krasniqi
dhe Jelena Petroviq*

Hyrje: Çështja politike është personale

Me ndryshimin e slloganit feminist nga vitet e vona 60-të çështja personale është politike në çështja politike është personale, nga vitet 90-të e deri më sot aktivizmi në pas-jugosllav tregon se si miqësitë politike dhe lidhjet feministe përhapen përmes përvojave të përditshme personale dhe strategjisë së rezistencës që t'i konfrontojnë strukturat e gjera shoqërore dhe politike të luftës, etno nacionalizmit dhe tranzicionit. Hulumtimet të cilat kanë të bëjnë me trashëgiminë e aktivizmit të grave dhe praktikat e sotme politike femiste shpërfaqin tema të ndryshme të imagjinimit shoqëror të cilat shpiejnë në ardhmërinë e emancipuar politike, por tashmë edhe në pozicione të cilave u nevojitet riartikulimi.

Kur flasim për hapësirën pas-jugosllave dhe shoqërinë, hyjmë në një zonë të angështimit dhe të druajtjes në luftën e shkaktuar të përhershme gjeopolitike midis miteve nacionaliste dhe të kaluarës nostalgjike, historisë së pamundshme dhe krizave të tanishme, dhe

definitisht, shpresës së përhershme dhe ardhmërisë distopike. Sot, Jugosllavia nuk paraqet vetëm një hapësirë gjeografike, por edhe politike si simbol shoqëror i perceptimeve dhe kuptimeve meta-gjeografike, të politikave të kundërshtuara të përkatësisë, por të rëndësishme në ndërtimin e njohurive të përbashkëta historike. Pamundësia që kjo njohuri të krijohet në bazat e përbashkëta është simptom i luftës që ende vazhdon të zhvillohet në këtë hapësirë, por me përdorimin e mjeteve të ndryshme, administrative, nacionaliste, ekonomike dhe politike. Çështje fillestare në këtë proces të përbashkët të krijimit të njohurive historike për hapësirën pas-jugosllave është a jemi duke folur për një luftë e cila e nënkupton fundin e erës utopike të socializmit, si edhe fundin e shtetit social, ose, nga ana tjetër, atë që kemi këtu një sërë luftërash nacionaliste të cilat, pas rezistencës nacionaliste disidente pas Luftës së Dytë Botërore dhe tranzicionit të armatosur të viteve 1990-ta, ka vendosur sistemin hegjemonist i cili i ka shfarosur njerëzit në bazë të nacionalitetit të tyre, religjionit ose statusit tjetër

të pakicës, duke përdorur mbizotërimin në fuqi, armët, popullsinë si edhe lakminë kur është fjala për privatizimin në pas-socializëm dhe grumbullimin e pasurisë përmes praktikave korruptive.

Vend i rënies viktimë, shkatërrimit dhe terrorit, traumave të luftës dhe gjenocidit nga vitet 1990-ta janë vendet në të cilat Jugosllavia socialiste e humbi artikullimin e vet politik të së kaluarës edhe imagjinatën e të së ardhmes së përbashkët. Politika e mba-mendjes dhe diskursi pacifist i pajti-mit, që është krijuar që nga viti 1990 kanë neutralizuar nevojën për subjek-tivizim politik si dhe nevojën për historizimin e përbashkët të luftës. Kjo në fakt ka qenë luftë në të cilën Jugosllavia nuk arriti t'i mposhtë simbolet nacionaliste të të ashtuquaj-turit demokratizim i shoqërisë përmes kërkesave neoliberales të kapitalizmit global, postsocialist, shpërndarës në të cilin të gjitha shtetet e porsa formuara pas-jugosllave u bënë periferi të ballkanizuara të Evropës postsocia-liste, secila e bazuar në luftën e vet të pafund. Pamundësia e shpërbërjes së strukturave të ngurtësuara patriarka-

le, etno-nacionaliste dhe të korrup- 21
tuara të jetës së përditshme tregon se
shtetet e reja pas-jugosllave sot e
ndajnë logjikën neoliberale të luftës
së përhershme si vazhdim i luftës së
mëparshme nga vitet e 1990-ta.

Pas bashkëpunimit dhe punës së përbas-
hkët për këto dy çështje të rëndësis-
hme *Jugosllavisë* dhe *feminizmit*, si
autore të këtij studimi, kemi dashur
që të merremi me çështjen e luftës dhe
të paqes në hapësirën pas-jugoslla-
ve nga perspektiva feministe që do të
vërë në fokus disa nga mendimet dhe
aksionet e rëndësishme politike. Ky
hulumtim për aktivizmin e grave dhe
feminizmin nisët nga angazhimet poli-
tike dhe personale brenda Jugosllavisë
si hapësirë gjeopolitike e parehatisë.
Përveç kësaj, studimi shoqërohet nga
intervistat me aktiviste, shkencëta-
re, personalitete që merren me kul-
turë të cilat nga perspektivat e nd-
ryshme të kohës (para dhe pas viteve
të 1990-ta) dhe hapësirës (Kosova dhe
Serbia) zbulojnë betejën e ardhsh-
me dhe të përbashkët të grave kundër
strukturave të rrënjosura shtypëse,
hegjemoniste, patriarkale të formuara

me lidhjen lokale specifike të etno-nacionalizmit dhe neoliberalizmit. Përmes qëndrimeve personale, Olga Dimitrijeviq, Zana Hoxha-Krasniqi, Lepa Mlagjenoviq, Igballe Rogova, Aleksandra Sekuliq, Svetlana Slapshak, Jelena Vishnjiq dhe Blerta Zeqiri flasin për aktivitetet aktuale dhe mendimet, por edhe për historinë e së sotmes përmes së kaluarës së aktizimit të grave, rikthesave, gabimeve dhe luftës, si edhe për përfytyrimet e veta feministe të ardhmërisë së përbashkët jashtë themeleve patriarkale, neoliberale dhe nacionaliste të shtetit dhe shoqërisë.

Fjalori i (pa)mundshëm pacifist/aktivist dhe feminist

Kur flitet për çështjen e përgjegjësisë politike dhe angazhimit shoqëror në lëvizjet e grave, feministe dhe ato kundër luftës, gjithnjë shpërfaqet po ashtu lufta rreth nocioneve, kuptimit dhe koncepteve ideologjike. Përdorimi i gjuhës dhe përvetësimi i nocioneve pacifiste, aktiviste dhe feministe në diskurse publike, politike dhe të orgaizatave jo-qeveritare (OJQ) shumë

shpesh relativizojnë ndjenjën e paqes, 23 lirisë, të drejtave shoqërore dhe të njeriut, drejtësisë, etj. Proceset e kaluara dhe të tanishme të gjyqimit të krimeve të luftës, pajtimit, normalizimit brenda hapësirës pas-jugosllave kanë shkaktuar shumëllojshmëri të reja të problemeve, shoqërore dhe politike. Duke pasë këtë parasysh, çështja kryesore për lëvizjen e grave dhe politikën feministe nga vitet e 1990-ta e këndej ka qenë: Si të ndërtojmë bashkë idenë e paqes dhe të lirisë në të gjitha baraspeshimet historike, politike, shoqërore dhe ekonomike të luftës/luftërave në Jugosllavi? Dhe për më shumë, sot në kohën e luftës së përhershme?¹

Dy raste referuese për shkak të të cilave ka qenë e pamundur të zgjidhet kjo çështje në mënyrë të tërësishme, jashtë të vërtetave të dyfishta ose të shumëfishta për konfliktet, luftën,

¹ Pas sulmeve terroriste më 11 shtator të vitit 2001, administrata e Bushit shpalli luftën botërore kundër terrorizmit (nën parullën: *ose jeni me ne, ose jeni me terroristë*) duke përfshirë diskurse të reja dhe legjislacion për sigurinë.. Lufta kundër terrorizmit ose lufta e përhershme u bë ideologji e re e frikës dhe represionit, duke kufizuar paqen dhe lirinë.

tranzicionin, normalizimin dhe procesin e pajtimit do të konsiderohen paradigmatiche për të menduarit politik dhe aktivizmin brenda kësaj gjeografie shtrruese të hapësirës pas-jugosllave. Rasti i parë ka të bëjë me çështjen kryesore të konferencës të emërtuar: *RE-Daktura: feminizmi transjugosllav dhe trashëgimia e grave në rishikim* (tetor 2011, Zagreb), dhe paneli: *Çfarë Mbetin nga e Majta Feministe?* me theks në aktivizmin politik, feminizëm të kuq dhe artin shoqërisht të angazhuar në shtetet pas-jugosllave dhe shtetet e tjera post-socialiste evropiane. Konferenca mbledhi zërat kritikë dhe politikë të teoreticenteve të shquara feministe, aktivisteve dhe artisteve të cilat e shqyrtuan të kaluarën jo të lavdishme dhe të tanishmen e padurueshme përmes ardhmërisë së mundshme të përbashkët në të cilën lëvizja e bashkuar e grave do të ishte bazë e politikës emancipuese e cila do të bazohej në idenë e barazisë dhe drejtësisë për të gjithë.

Rasti i dytë ka të bëjë me platformën e teorisë dhe artit dhe bashkëpunimin në projektin e titulluar: *Çfarë nënkupton sot lufta?* (2010-2011) inicuar nga Gru-

pi Spomenik/Përmendorja dhe grupet e 25
ndryshme të përkthimit nga hapësira e
pas-jugosllave dhe më gjerë². Një nga
momentet kryesore të këtij projekti
përkthyes ishte pjesëmarrja në ekspo-
zitë në galerinë NGBK në Berlin e ti-
tulluar *Spaceship Yugoslavia* (shtator
2011, Berlin). Përmes këtij projekti
shqyrtoi përvojat e pas-Jugosllavisë
dhe luftërave të sotme, si dhe nocio-
net: kombi, siguria, dhuna, ndërhyrjet
luftarake dhe paqësore në forma të nd-
ryshme (libra, punëtori, ligjërata).

Pra, duke u sjellë midis punës indivi-
duale dhe praktikës kolektive, këto dy
raste paradigmatiche i zbulojnë pikë-
pamjet e shumë aktivistëve të bazua-
ra në njohuri emancipuese dekoloniale,
feministe dhe materialiste, veçanërisht
në atë që sjell politikën e afekteve
në fushën e mendimit politik dhe jetës

² Në qëllimin e vet, kjo platformë u mor me përkthimin e tekstit të Silven Lazaris (Sylvain Lazars) “L’importance des mots: la guerre et la paix”, me grupin e artistëve, intelektualëve dhe studentëve. Pjesëmarrësit të cilët ishin të angazhuar në përkthim shtruan pyetje për botëkuptimet bashkëkohore të kuptimit të luftës. Në kontekstin e luftës së sotme globale dhe të vazhdueshme, ata u morën edhe me rrjetin e nocioneve themelore të cilat kontribuojnë që të kuptohet historia e luftërave në Jugosllavi.

shoqërore përmes zërave performues, përshkrimeve vizuale dhe paraqitjeve publike.

Çfarë mbeti nga e majta feministe?

Në kuadër të panelit të konferencës së përmendur: Çfarë mbeti nga e majta feministe?, janë shtruar shumë pyetje të cilat kanë të bëjnë me feminizmin e majtë/të majtën feministe dhe gërs-hetimit midis lëvizjeve feministe dhe pikëpamjeve në hapësirën pas-jugosllave. Çështja e politikës feministe, kontinuitetit të saj dhe diskontinuitetit, poashtu edhe emancipimi është shumë më shumë aktuale tani se sa ishte më parë. Prandaj paneli adresoi çështjen: çfarë mbeti sot nga e majta feministe? Duke i dekonstruktuar bazat historike, teorike dhe ideologjike të së majtës dhe feminizmit, sepse në realitetin e sotëm shoqëror nuk ka shumë nga ajo që i bashkon këto nocione.

Për këtë arsye, nocioni “e majta feministe” tashmë një kohë të gjatë në mënyrë arbitrare po keq/përdoret

për konstruimin e asaj që do të duhej tashmë të nënkuptojë vetë aktualitetin e saj. Është fakt se nocioni “ e majta feministe” nuk flet as për idenë e re shoqërore dhe politike as për entuziazmin e zjarhtë të lëvizjes vetëorganizuese të grave punëtore në fillim të shekullit XX. Sot ky nocion merret me lëvizjen politike e cila e ka qëllimin e vet dhe real-politikën pas vetes, si edhe me rrymat e ndryshme të majta të cilat gradualisht po vendosen përmes ekonomisë bashkëkohore, politikës dhe opinionit akademik, si edhe përmes fondacioneve të cilat i mbështesin bashkë me dyfishimet dhe gabimet e shumta. Pozitat feministe brenda së majtës dhe mobilizimi i grave brenda tyre jo domosdoshmërisht nënkupton emancipim, jo në kuptim shoqëror-ekonomik, e as në ndonjë kuptim tjetër, kjo bëhet e dukshme kur studjojmë historinë e së majtës dhe transformimet shoqërore, por duke mos harruar se në socializëm partia mori rolin e *pater*. Perpetuimi i patriarkatit në socializëm ishte evident në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, që nuk çoi në transformimin e punës në shtëpi dhe formave të familjes, duke rezultuar

në punën e dysfishtë të grave - punën jashtë shtëpisë dhe punët shtëpiake, që ndikoi në pjesëmarrjen e tyre në jetën politike. Pozitat feministe sot në spektrin politik të së majtës nuk mund të jetë e njëjtë si në momentin e mohimit historik në favor të kinse universalizmit i cili nuk arriti sukses në misionin e vet parësor: që të sigurojë barazinë e grave dhe burrave në një shoqëri pa klasa. Në panel u shtruan shumë çështje për kuptimin e nocionit “e majta feministe” - para se gjithash në kontekstin pas-jugosllav të trashëgimisë dhe (mos)kontinuitetit - bashkë me kërkesat politike që këto lëvizje sot duhet të (ri)artikulojnë ballafaqimin me ekonominë aktuale shoqërore-politike të jetës së përditshme.

Duke menduar për këtë, me rëndësi është të theksohet se nocionet *jugosllav* dhe *pas-jugosllav* në kontekstin e pozitës vazhdimisht të marginalizuar të shkollave feministe dhe përpjekjes së ndërhyrjes kritike, në asnjë mënyrë nuk kanë qenë homogjene. Feminizmat jugosllavë si fakt historik dhe feminizmat jugosllavë si pozicion poli-

29
tik - janë formuar në trekëndëshin e tranzicionit kombi-klasa-gjinia gjatë fund viteve të 1980 dhe janë zhvilluar gjatë luftës në vitet 1990 - duhet të vështrohen edhe si zhvillim diakronik/historik edhe si veprim i sinkronizuar/politik i praktikave të përbashkëta feministe brenda procesit aktual të pozicionimit të “majtizmit”.

Për feminizmin pas-jugosllav, çështja e përgjegjësisë nënkuptoi definimin e pozitive ndaj luftërat e viteve 1990-ta. Lëvizja feministe e asaj kohe mbeti “jugosllave” edhe përkundër kundër-ngjarjes vendimtare i cili e suprimoi Jugosllavinë si subjekt politik në favor të hegjemonizmit etnonacionalist menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit në vitin 1989. Poashtu, mund të thuhet se feminizmi jugosllav (si lëvizje unike) e rigrupuar në feminizma pas-jugosllavë (si strukturë plurale), që u zhvilluan kryesisht në dy drejtime: akademike dhe aktiviste, kurse më vonë u ndan në drejtime kulturore, juridike, administrative, si edhe në fusha të tjera specifike të shoqërisë civile, duke vepruar kryesisht si ndërhyrje korrigjuese në

politikën e identiteteve të porsaformuara gjinore, kombëtare dhe klasore, duke i verifikuar numrat dhe duke i plotësuar kuotat – pra, me përdorimin e strategjive neoliberalë të vendosjes së paqes sociale.

Edhe pse në këtë moment kritika e angazhimit pas-jugosllav feminist liberal do të ishte e arsyetueshme, me rëndësi është së pari të vlerësohet kur ato praktika feministe janë vendosur, njëkohësisht duke shtruar këtë pyetje: a mundet e majta vërtet ta rimarrë përgjegjësinë për ndërhyrje politike në fushën e feminizmit dhe ta nxisë që të ballafaqohet me përgjegjësinë për realitetin politik të së sotmes? Duke pasur parasysh se e majta pësoi transformim dhe praktikisht u zhduk nga skena politike gjatë procesit jashtëzakonisht turbulent dhe të dhunshëm të privatizimit të pronësisë shoqërore, që të kthehet atje pasi që “transformimi në shoqëri demokratike kapitaliste” pësoi kolaps ekonomik, shtrohet pyetja a do duhej feminizmi përsëri të vendoset në të majtën ose brenda saj, ose do të mjaftonte të rishqyrtohej diapazoni i të veprimit

feminist në kuadër të praktikave të 31
qëndrueshme të ndërhyrjes politike dhe
emancipimit shoqëror?

Me fjalë të tjera: a duhet të riarti-
kulohet sot feminizmi - njëkohësisht
duke vlerësuar praktikën e vet në
krahasim me shoqërinë dhe me trazirat
shoqërore dhe ekonomike - duke ven-
dosur kërkesa përkatëse dhe duke i
aplikuar mënyrat e reja të veprimit
bashkë me të ashtuquaturën të majtën
e re (e cila përsëri u rivendos në
hapësirën pas-jugosllave në formë të
lëvizjeve studentore dhe lëvizjeve të
tjera aktiviste përmes kërkesave për
arsim falas, me kritikë politike dhe
ekonomike të integriteteve evropiane dhe
nismave të ngjashme)? Nëse e shqyr-
tojmë kritikën retrospektive të femi-
nizmit pas-jugosllav me pikëpamjet e
sotme majtiste, dhe hyjmë në analizë
gjithpërfshirëse, veçanërisht se fe-
minizmi nuk ka qenë mjaft efikas në
vitet e tranzicionit shoqëror, së pari
duhet të ballafaqohemi me iluzionin e
kontinuitetit të rrejshëm në veprimin
e të majtës në kuptimin e ndërmarrjes
së aksioneve kolektive për ruajtjen e
shoqërores së përbashkët në kuptimin

politik dhe ekonomik, në kontekstin pas-jugosllav.

Që raporti midis feminizmit dhe të majtës të përkufizohet haptazi, në radhë të parë në procesin emancipues të formimit të subjektit politik dhe të kuptuarit të historisë së parapakoishme politike, duhet bërë me dije faktin se as feminizmi as e majta nuk dhanë përgjigje drejtpërsëdrejti ndaj sistemit shoqëror dhe ekonomik përmes procesit të privatizimit në luftë të pronësisë shoqërore në vitet e 1990-ta. Dallimi kryesor ishte në faktin që feminizmi mbeti këmbëngulës në qëndrimin e vet pacifist për luftën, duke e parë përgjegjësinë për atë çfarë ndodhi dhe drepjtërsëdrejti duke u marrë me problemin e prodhimit të “mbeturinës së njerëzve”³, që shërbeu si bazë e shoqërisë në tranzicion. Sepse siç

³ Ekzistojnë së paku tri kuptime teorike “kuptimit të mbeturinës njerëzore”: në aspektin simbolik, biopolitik dhe politik-ekonomik. Dy qasjet e para e ri/prodhojnë rendin shoqëror të arritur me regjistrimin e ndotjes, rreziqeve, tepricës, kontaminimit në Tjetrin me mjete të dhunshme të të ashtuquajturit spastrimit shoqëror dhe mbrojtjes (ndërhyrjes). Qasjet simbolike njerëzit/si/mbeturinë kryesisht i përfshijnë punimet e Mary Douglas (1966) dhe Julie Kristeva (1982), që kanë të bëjnë me kuptimin e çgradimit dhe refuzimit si proces i dëbimit, mundjes, poshtërimit dhe kontestimit.

pohon Jasmina Husanović: “ Riciklimi 33
i trupit, fshirja e jetëve të zhves-
hura/të pasigurta, tregtia me njerëz,
këto janë disa nga çështjet e rënda,
objekti/afekti të cilat na vërshojnë
kur fillojnë rrëfimet të zhvillohen
dhe kur i zbulojmë ekonomitë politike
të cilat na rrethojnë”⁴. Pikërisht për
këtë arsye duke e gjetur përgjigjen
për luftën - për kampet e përdendri-
mit, spastrimet etnike, terrorin, gje-
nocidin - në fillim dhe tërë rrjedhën
e vet, parashikimi feminist i priva-
tizimit të tranzicionit të shoqërisë,

Qasjet biopolitike përgjithësisht bazohen në punimet e
Michel Fukos (Michel Foucault 2003) për biolitikën dhe
racizmin, Gjorgje Agambenit, në homo sacer- dhe “jetën
e zhveshur” (1998), dhe Ashil Mbembe oper nekropoli-
tikën (2003). Dallimi është në vendosjen individuale
ose kolektive njerëzit-si-mbeturinë si kërcënim në
nivel të popullsisë. Kritika marksiste bazohet në
qasjen e tretë politike dhe ekonomike që shqyrton
njerëzit-si- si nusprodukt i mënyrës kapitaliste të
prodhimit. Marksi e përfaqëson tezën që kapitalizmi
vazhdimisht gjeneron akumulim njerëzor në formën e
“popullatës tepricë” të punëtorëve (*Kapitali, vëllimi I*),
dhe mëtutje “shkapërderdh denie njerëzore, fuqinë
e gjallë të punës”, duke rezultuar në “Shpërndarjen
e jetës dhe të shëndetit të punëtorëve” (*Kapitali,*
vëllimi III).

⁴ Jasmina Husanović, “Feminističke ekskurzije, trans-
verzalnosti, traverzije: o punoljetnim iskustvima so-
lidarnosti i zajedništva u proizvodnji znanja i eman-
cipativnoj politici”, *Feminizam - politika jednakosti*
za sve, Jelena Petrović and Damir Arsenijević (eds.),
Beograd: ProFemina, 2011, 49.

i fijes së kuqe të subjektivizimit politik sot, por edhe zonë e krijimit të diskursit kritik për sistemin aktual shoqëror-ekonomik. Mobilizimi politik i së majtës në një masë të madhe u krijua si moment i përçarjes së gjeneratave të reja “pas-jugosllave” gjeneratë për të cilën lufta si pikë e transformimit politik edhe ekonomik është njollë e verbër. Në procesin e krijimit “të perspektivave të reja të majta” – është logjike të përfundohet se vetëm vetëkritika dhe vetërefleksioni i pikave të verbëra mund të vendosin angazhimin politik dhe shoqëro. Prandaj politika e emancipimit sot mundet të reflektohet vetëm përmes vendosjes kritike të nocionit të relacionit të transformimit shoqëror, që do të barazonte feminizmin dhe të majtën.

Edhe përkundër trendit të parapakohshëm që të kritikohen praktikat feministe dhe aksionet politike në nivele të ndryshme, si personale ashtu edhe politike⁵, veçanërisht në kontestin e tendencave të reja të majta feministe, me rëndësi është të theksohet se thjeshtë-

⁵ Reagimet në konferencën REDaktura: feminizmi trans-jugosllav dhe trashëgimia e grave gjithashtu mund

simi i kritikës së feminizmit në vitet 35
1990-ta nuk është pikënisje e përshtat-
shme për politikën e emancipimit, edhe
pse ekzistojnë shkaqe të mjaftueshme
për kritikë gjithpërfshirëse . A ësh-
të një akt i tillë emancipues vërtet i
domosdoshëm për vendosjen e feminizmit
majtist sot, nëse e dimë se pikërisht
këto praktika të kritikuara feministe
gjatë viteve të 1990-ta dhe në fillim
të vitit 2000 kanë ndikuar që shumë
feministe të jenë të qenë të gatsh-
me të reagojnë ndaj situatës aktuale
shoqërore-ekonomike në të cilën gratë
shpesh ishin pala më e rrezikuar, nga
pikëpamja majtiste? Dhe cila do të is-
hte rëndësia politike e një akti të
tillë?

të shërbejnë si shembull në këtë çështje. Vëmendja
e mediave në radhë të parë u orientua në çështjen
spekulative kush sot ka të drejtë të flasë në emër
të së majtës feministe, që solli deri te paraqitja e
një sërë pozitive personale, pohimeve për merita dhe
konflikt në kombinim me monumentalizimin e feminizmit
jugosllav përmes biografive personale. Kjo lëvizje e
përqendrimit paksa e pengoi ngjarjen, qëllimi kryesor
i së cilës ishte që të siguronte hapësirë për kri-
tikë dhe (vetë)të menduar të feminizmave jugosllavë,
për shqyrtim produktiv për pikëpamjet feministe dhe
kërkesat bashkëkohore përmes lidhjes së gjeneratave
të ndryshme të feministeve, ndërldihjes së teorisë me
praktikën, dhe artit me aktivizmin.

Feminizmi i formuar nga ana e shoqërisë civile, i cili e dalloi gjininë si kategori bazë të marrëdhënieve shoqërore të krijuara në luftë dhe në tranzicion, duke vendosur politikën gjinore për të qenët i ndryshëm, përsëri u sh-tyt në margjina të shoqërisë civile tranzicioni i së cilës tashmë anticipoi – siç theksoi Nira Yuval-Davis⁶ në triadën e identifikimit, kombin, klasën dhe gjininë. Duke marrë parasysh konceptin e kombit i cili është ndërtuar përmes diskursit etnik-nacionalist, feminizmi gjithsesi arriti të krijojë hapësirë për politikë emancipuese në krahësim me diskursin mbizotërues nacionalist të viteve të viteve 1990-ta, duke e kundërshtuar me të gjitha mjetet. Mirëpo, çështja e diversifikimit klasor, që u paraqit si pasojë e ekonomisë së tranzicionit dhe ekonomisë së luftës nga vitet 1990 e më tutje, u zëvendësua me çështjen e ndërtimit të shoqërisë civile, në radhë të parë përmes kërkesës për politikë gjinore brenda paradigmës së gender mainstreaming [përfshirjes gjinore].

⁶ Nira Yuval-Davis, *Gender and Nation*, Londër: Sage, 1997.

Përveç kësaj, me veprimin përmes OJQ-ve, si edhe kanaleve insitucionale të zyrtare kombëtare dhe agjencive për barazi gjinore, politika feministe pjesërisht u transformua në politikën e gender mainstraming. Njëkohësisht, përpjekjet e ndërhyrjes në krijimin e njohurive, shqyrtimi kritik i teorisë dhe praktikës i mundësuar me paraqitjen e valës së tretë të feminizmit, i cili në mënyrë parësore u vendos përmes aktiviteteve të shkollave feministe dhe qendrave për studime të gjinore, por u bë i dukshëm në sferën publike përmes krijimit kulturor, artit dhe, deri dikund, mediave. Sferat e ndryshme të ndërhyrjes feministe dhe, para se gjithashë, përhapja e organizatave të ndryshme feministe dhe grupeve, si edhe puna në projekte hulumtuese, tërë kjo solli deri te copëtimi i lëvizjes së grave në vitet 1990-ta, dhe deri te ndarja në praktika aktiviste, akademike dhe kulturore dhe praktika të tjera të cilat sot edhe më shumë dallohen dhe profilizohen, duke lënë shumë pak hapësirë për veprim të përbashkët.

Krijimi i feminizmave të ndryshëm pas-jugosllavë në mënyra të ndryshme

ndikoi ndaj marrëdhënieve shoqërore, por politikat e tyre të ndryshme nuk kanë qenë mjaft të fuqishme që të imponohen si forcë bazë ose dominuese e jetës politike dhe shoqërore. Nga ana tjetër, kërkesat e tyre politike nuk kanë qenë mjaft të konsoliduara që të krijohet lëvizja unike e grave që të mund të tejkalojë hendekun artificial midis aktivizmit dhe bashkësisë akademike, teorisë dhe praktikës, barazisë dhe dallimit. Pikërisht kjo mungesë e qartë sot na detyron që të ballafaqohemi me kthesat e reja dhe t'i theksojmë kërkesat e reja feministe të cilat do ta pranonin domosdoshmërinë e krijimit të lëvizjes së përbashkët feministe, kurse njëkohësisht duke gjetur dalje nga rrethi i mbyllur i të kritikuarit dhe rizbulimit të feminizmit varësisht nga fleksibiliteti aktual i marrëdhënieve patriarkale dhe vlerave - në vend që të kërkojmë përgjegjësi për krijimin e secilit sistem - të kaluar dhe aktual - shoqëror dhe politik.

Duke u marrë me (pa)mundësinë e filimit të lëvizjes unike pas-jugosllave të grave, po bëhen përpjekje që të

vendoset kontinuiteti i të menduarit 39
kritik të së kaluarës jo të largët dhe
(vetë)të menduarit për domosdoshmërinë
e vendosjes së lidhjeve diakronike dhe
sinkronike midis të gjitha lëvizjeve
të grave dhe lëvizjeve feministe dhe
krijimit të një hapësirë autonome. Kjo
hapësirë do të ishte ideuar si zonë e
përkohshme e grave, ku për emancipim
politik dhe riprodhimin shoqëror të
jetës së përditshme nga pikëpamja e
feminizmit të së majtës, i aftë për
analizë kritike ose afirmative të sh-
kollave, teorive dhe praktikave të zh-
villuara nga ana e lëvizjeve të ndry-
shme feministe (ose më mirë të thuhet
grupeve), njëkohësisht duke iu shman-
gur që të lejojnë që vetëlavdërimi i
jashtëzakonshmërisë së vet dhe punës
“prej pionierje” ta zëvendësojë tras-
hëgiminë e vlefshme dhe përvojat.

Nga kjo pikë e vështrimit ekziston ne-
voja për kthimin në feminizëm dhe në
aktualitetin që mban dhe që të bëhen
përpyekje që të lirohem nga traumat
e konflikteve të ndryshme brenda femi-
nizmit, para se gjithash midis gjene-
ratave, të cilat gjithnjë janë themele
në vënien e kontekstit të së kaluarës

dhe së tashmes në një rrafsh, dhe që, në historinë e lëvizjes, duket të jetë paradigmatiche. Në një proces të tillë me rëndësi është që të ndalet zënia e pozitës së sulmuesit dhe viktimës, sepse këto pozicione, megjithatë janë patriarkale. Kjo, natyrisht, na kthen në subjektivizimin politik të feminizmit dhe çështja lidhur me të se në çfarë baze do të duhej të ndërtohet politika emancipuese. Pikë fillestare e feminizmit sot duhet të jetë prerja midis të tanishmes dhe të kaluarës, ajo që do të gjenerojë diskurse dhe praktika emancipuese, dhe ajo që do të mundësojë ndërprerje dhe mohime të kontinuitetit ende gjithnjë të papërkryer të emancipimit shoqëror të grave dhe shoqërisë. Sa i përket trashëgimisë feministe dhe dallimeve në botëkuptimet e saj, është e domosdoshme të mendohet historia e atyre dallimeve që të rishqyrtohet: çfarë ende jemi duke u munduar të përkufizojmë me shprehjen e majta feministe? Dhe në të njëjtën kohë: A është e majta kornizë e vetme në të cilën është e mundur të mendohet për politikën e subjektivizimit majtist të lëvizjes së grave në të ardhmen?

Ekziston edhe një çështje thelbësore pa të cilën është e pamundur të pozicionohet politikisht cilado lëvizje ose përpjekje pas-jugosllave, e kjo është njohuria e përgjithshme për Jugosllavinë. Politika e kujtesës, ekonomia e luftës dhe njohuria emancipuese për Jugosllavinë u patën përfshirë në grupin teorik Grupi Përmendorja në praktika të ndryshme diskursive, ekspozuese dhe në performansa, të shkaktuara me pamundësinë e ndërtimit dhe emërtimit të përbashkët të përmendores lidhur me luftërat nga vitet e 1990-ta. Grupin Përmendorja e themeloi në vitin 2002 artistja Milica Tomiq, kurse në punën e saj morën pjesë anëtarët e përhershëm dhe ata mysafirë rreth projekteve të forenzikës, humltuese, diskutuese dhe ekspozuese, si edhe njerëzit të cilët në çfarëdo mënyre janë marrë me luftë, ose thjesht e kanë mbijetuar luftën. Puna brenda kornizës së njohurive të nënshtuara [subjugated knowledge] për Jugosllavinë dhe projektin e forenzikës për gjenocidin në Srebrenicë u

titullua *Matemët e riasociacionit*⁷, shtron pyetjen “Çfarë nënkupton *lufta sot?*”, që rezultoi me zhvillimin e projektit tashmë të përmendur me të njëjtin emër përkthimi-artistik.

Projekti “Çfarë nënkupton *lufta sot?*”, si platformë u zhvillua në 2010-2011, dhe mbledhi së bashku grupet përkthuese të artistëve, teoreticentëve, aktivistëve, akademikëve, veprimtarëve të kulturës dhe aktorëve të tjerë të interesuar që të marrin pjesë në punën e Grupit Përmendorja në vendndodhje të ndryshme: Prishtinë, Lubjanë, Mastriht, Zagreb, Tuzllë, Beograd, Mostar, Berlin. Bazë e kësaj pune kolektive në teorinë e artit ishte përkthimi i tekstit të Ketrin Has (Catherine Hass 2010): *Qu’appell-t-on une guerre? Enquete sur le nom de guerre aujourd’hui* (Çfarë është kuptimi i luftës? Hulumtimi i emrit të luftës sot?) me shfrytëzimin e metodës *arsimari ignoramus*, d.m.th., mungesës

⁷ Matemët e riasociacionit janë projekt i Grupit Përmendorja në të cilin artistët, teoreticentët dhe aktivistët bashkërisht i shqyrtojnë mënyrat sipas të cilave ideologjia e pajtimit përmes shkencës së forenzikës e depolitizon gjenocidin (me gjenocid në Srebrenicë si pikë fillestare).

së çfarëdo autoriteti në krijimin e njohurive dhe pa njohuri paraprake të gjuhës burimore.⁸ Puna gjatë përkthimit e nxiti shqyrtimin lidhur me luftërat gjatë viteve të1990-ta, dhe më tutje për luftën e përhershme. Koncepti bashkëkohor i luftës dhe kuptimi i sotëm i saj, që trajton teksti i Ketrin Has, shtruan një sërë pyetjesh dhe si rezultat patën vendosjen e rrjetit të nocioneve themelore në të kuptuarit e historisë së luftërave në Jugosllavi jashtë narrativave ekzistues dhe rrjedhës kryesore të luftës.

Ky projekt artistik, shoqëror dhe teorik, i bazuar në përkthim me pjesëmarrje dhe mendim kolektiv, u ideua si vend i krijimit të njohurive të përbashkëta, shoqërisht të angazhuara dhe politikisht subjektivuese historike lidhur me luftën. Përmes këtij projekti, Grupi Përmendorja e nxiti vetëdije politike për Jugosllavinë në kontekstin e luftës, kriminalite-

⁸ Metodologjinë e projektit artistik e propozoi psikoanalisti Branimir Stojanović, anëtar i Grupit Përmendorja, duke u bazuar në revolucionin pedagogjik të cilin e filloi përkrahësi jakobin Jill Jacoto, dhe që e nënkupton mungesën radikale të arsimtarëve në procesin arsimor.

tit dhe gjenocidit, duke parashtruar mundësinë e të menduarit të bashkë-n-darë të kësaj hapësirë gjeopolitike të cilën e quajmë pas-jugosllave. Kjo rezultoi sfiduese, duke lënë të hapur hapësirën për një kuptim të bashkë-n-darë të së kaluarës dhe të tashmes.

Duke shikuar më gjerë, dy ngjarje të rëndësishme historike, siç janë rënia e murit të Berlinit dhe 11 Shtatori, shndërruan konfliktet e mëparshme ideologjike në konflikte midis Lindjes dhe Perëndimit, në një të ri, të strukturuar nga ana e ekonomisë politike dhe liberale e të jetuarit dhe vdekjes në shoqërinë globale neoliberale dhe në luftë-shtetin. I përkufizuar me forcë, dhunë dhe frikë, shteti thekson se logjika kryesore e dominimit në botë sot është logjika e luftës⁹, e cila e keqpërdor kuptimin e lirisë, demokracisë dhe paqes në mbrojtje të sistemit global i mosbarazisë neoliberale në nivele të shumta: shoqërore, politike, ekonomike, ushta-

⁹ Marina Gržinić, "From Biopolitics to Necropolitics and the Institution of Contemporary Art", Pavilion, Journal for Politics and Culture, No.14, 2010, 59.

rake dhe nivele të tjera.¹⁰ Hulumtimi 45
i Ketrin Has për çështjen: *Emër i kujt
është sot lufta?* Dëshmon për gjendjen
aktuale të luftës, vazhdimësinë dhe
domosdoshmërinë e saj, qëllimi i kujt
është, siç theksoi, nuk është arritja
e paqes¹¹, sepse dallimi midis luftës
dhe paqes më nuk ekziston. Prandaj,
lufta bashkëkohore domosdoshmërisht
është e përhershme, sepse nuk ekzis-
ton qëllimi i brendshëm politik, sub-
jektiv i cili do ta caktonte fundin e
saj, e kjo është paqja. Konfliktet e
përhershme pas-jugosllave të trashëgu-
ara nga luftërat e viteve të viteve të
90-ta jashtëzakonisht mirë përputhen
përshtaten në kuptimin e sotëm global
të luftës.

Pas përpjekjeve të shumta feminis-
te ose politike të ripërkufizimit të
gjeopolitikës, si edhe historisë së
hapësirës pasojugosllave, veçanëris-

¹⁰ Jelena Petrović, "What Does Freedom Stand for To-day?" In: *Border Thinking* (ed. Marina Gržinić), Berlin: Stenberg Press and the Academy of Fine Arts Vienna. 2018, 112.

¹¹ Shih Catherina Hass, "*Qu'appelle-t-on une guerre? Enquête sur le nom de guerre aujourd'hui*," disertacion i doktoratës, Université Paris 8, Paris, 2001.

ht pas rënies së komunizmit në Evropën Lindore, e pranishme është edhe pamundësia e përkufizimit të cilësdo zone gjeografike jashtë ndarjes hegjemoniste të pushtetit. Zingjirët e migrimit, refugjatëve dhe dhunës në luftë, diversifikimi ekstrem klasor, ngritja globale e politikës djathtiste dhe fashizmit bashkë me ndryshimet katastrofale klimatike janë bërë kornizë globale gjeopolitike e hapësirës pas-jugosllave, por edhe e shoqërisë së sotme neliberale në tërësi.

Me përdorimin e mjeteve të ndryshme të diversifikimit - më të vjetra, siç janë mekanizmat kolonialë, kapitalistë dhe patriarkalë të (ri)rodhimit shoqëror dhe gjeografik dhe atyre të reja, siç janë metodat teknologjike, shkencore dhe (tekno) kulturore të identifikimit politik dhe territorial - është e qartë se bota jonë globale u bë hapësirë gjeopolitike në të cilën shumica e njerëzve nuk e ndjen që i takon. Liria në këtë moment paraqitet si nocion bazë dhe arbitrar i shoqërisë neoliberalë, nocion i cili e arsyeton gjendjen e luftës (që përbëhet nga të gjitha krizat e

para pak kohshme dhe aktuale politike, ekonomike dhe sociale) dhe përmes saj zhvillohen interesat dhe jobarazitë “liberale”. Mjetet aktuale të mbrojtjes demokratike të njerëzimit, siç janë: ndërhyrja ushtarake, masat e kursimit, politika e refugjatëve, ndihma humanitare, ligjet e migrimit, të drejtat e njeriut etj., janë diskurzive dhe ideologjikisht të bazuara në kuptimin e lirisë. Këto mjete (bashkarisht) prodhojnë mekanizma neoliberalë të qeverisjes globale, si edhe gjendjen e përhershme e krizës, konfliktit dhe terrorit. Horizontet e tilla të anasjellta të lirisë sot e përjashtojnë çdo mendim kritik, arsimim, organizim, rezistencë dhe jetesë jashtë konceptit neoliberal të ligjshmërisë. Zgjedhja e rreme midis mjeteve legale dhe jolegale të rezistencës shoqërore, beteja politike për liri e hap çështjen për kufijtë e praktikave politike, teorike dhe artistike, si edhe çështjen e kundërshtimit të përgjegjësisë dhe subjektivitetit politik të shumë mendimeve feministe dhe procedurave.

Çfarë është kuptimi i lirisë?

Kjo është çështja të cilën Angela Dejavis (Angela Davis), si edhe shumë pacifiste dhe feministe të tjera, i shtroi pas aq vitesh beteje, mendimit dhe rezistencës ndaj mekanizmave represivë në struktura të pushtetit të botës sonë bashkëkohore.¹² Në një kuptim idealist, një liri e tillë është betejë e përhershme, e cila ka të bëjë me termin e revolucionit të përhershëm që është themel i emancipimit shoqëror dhe lirisë së fituar përmes betejës/rezistencës/revolucionit, etj. – ardhmëri rrënjësisht më ndryshe, parakusht bazë për transformim kolektiv emancipues jashtë robërimit, kolonializmit, racizmit, patriarkatit, kapitalizmit, fashizmit dhe kështu me radhë. Mirëpo, njëkohësisht, përmes ngjarjeve të rëndësishme historike dhe transformimit material (post)ideologjik të shtetit, liria u bë fjala më e shtrenjtë e shoqërisë së globalizuar neolibérale.¹³

¹² *Kuptimi i lirisë* është titulli i librit të Angela Dejavisit i cili përbëhet nga fjalimet publike, intervistat, tekstet, dhe kështu me radhë.

¹³ *Liria: fjala më e shtrenjtë kapitaliste* është titulli i shfaqjes teatrore e cila bazohet në udhëtimin

Sot kuptimi i lirisë (keq)përdorur si 49 sinonim fetishizues për ligjin e atyre të cilët përgjithmonë janë vendosur në kuadër të sistemit neoliberal të pushtetit politik dhe ekonomik. Duke i paramenduar liritë revolucionale përmes kërkesës më të fuqishme kolektive për shoqëri të re (uniteti), që kërkon koncept radikal emancipues të bashkësisë së ndërlikuar jashtë strukturave ekzistuese të pushtetit të shtetit neoliberal dhe aparateve të saj rregullative dhe represive, Dejvis e rikujton se liria është proces i ekzistimit. Me fjalë të tjera, ky është proces në të cilin “jemi në gjendje të shohim dhe të kuptojmë dallimin brenda unitetit dhe të kundërshtojmë tendencën që të riprodhojmë hierarkitë e ndërtuara në botën të cilën duam ta ndryshojmë.”¹⁴

hulumtues të autores në shtetin më të izoluar në botë – Korenë Veriore. Autoret, Maja Peleviq dhe Olga Dimitrijeviq, e rishqyrtojnë idenë e lirisë në kohën e mbikëqyrjes gjithnjë më intensive globale dhe ballafaqimin me propagandën ekzistuese dhe stereotipet mbizotëruese të regjimit totalitar veriorokorean dhe demokracive neoliberale perëndimore. Shih <http://festival.bitef.rs/event/freedom-expensive-capitalist-word/>.

¹⁴ Robin D. G. Kelley, foreword to Angela Y. Davis, *Meaning of Freedom*, 14.

Duke u marrë me të gjitha çështjet bashkarisht, studimi do të përcjellë aksionet pas-jugosllave të grave dhe feministe dhe praktikën e tjera të rëndësishme individuale të cilat e aktualizojnë, konceptualizojnë dhe ideojnë politikën e lirisë jashtë mekanizmave ekzistues neoliberalë, patriarkalë, kolonialë të shtetit sot. Tërë kuptimi i pikëpamjeve të ndryshme aktiviste, kulturore, artistike dhe pikëpamjeve të tjera për luftën/luftërat gjatë viteve të 90-ta gjenerohet përmes disa nga këta shembuj të pacifizmit dhe feminizmit në këtë zonë turbulente dhe të shterruar gjeopolitike të parehatisë e cila në radhë të parë ka të bëjë me dy shtete pas-jugosllave: Kosovën dhe Serbinë.

Çfarë do të thotë aktivizmi i grave? Midis praktikës kolektive dhe punës individuale

Fija e kuqe e kuptimit unik të angazhimit feminist dhe angazhimit të grave mund të përcillet përmes disa nga këta shembuj paradigmaticë. Në pajtim me këtë, ky kapitull paraqet gjashtë

raste paradigmatiche të praktikave të angazhuara shoqërisht, të cilat merren me temën e pacifizmit dhe të politikës kundër luftës në nivele të ndryshme, e të cilat kanë të bëjnë me veprimin kolektiv të grave dhe me punën individuale të aktivisteve dhe të artisteve. Dy projekte të zgjedhura flasin për aktivizmin kolektiv të grave, e këto janë Projekti *Gratë e Ballkanit për Paqe*¹⁵ dhe *Gjykata e Grave për-ish Jugosllavi*¹⁶. Që të theksohet lidhshmëria e ndërsjellë e praktikave kolektive dhe punës individuale, është pasqyruar rrëfimi jetësor i Didare Gjorgjeviqit, lidere në kohën e socializmit në Kosovë dhe në Jugosllavi e cila u paraqit që të theksojë kohësinë dhe kontinuitetin e angazhimit të grave në sferën publike. Aq më parë, këtu lidhemi me aktivizmin e grave duke e shikuar numrin e zgjedhur të projekteve shoqërisht të angazhuara artistike në të cilat gjendet aktivizmi i grave dhe arti. Qëllimi kryesor këtu është të diskutohet për faktin se si aktivizmi i grave formëson narrativat dhe

¹⁵ <http://www.transeuropeennes.org>

¹⁶ <http://www.zenskisud.org/en/>

praktikat e politikës kundër luftës dhe se si është formuar në mënyrë prapavepruese.

Gratë e Ballkanit për Paqe: Aktivistet i kalojnë kufijtë

Me qëndrimin që “teoria dhe aksioni nuk janë të përjashtuara reciprokisht, por që janë në ndërveprim të përhershëm”, rrjeti Gratë e Ballkanit për Paqe u krijua nga Projekti *Transeuropéennes* i cili ka qenë aktiv nga viti 1993 deri në vitin 2005 si përgjigje lidhur me transformimet shoqërore dhe politike pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Luftës së Gji-rit Persik dhe luftërave në ish-Jugosllavi.¹⁷ Gratë e Ballkanit për Paqe ishte kolektiv i grave akademike, aktivisteve për të drejta të njeriut, të OJQ-ve dhe mediave nga Shqipëria dhe ish-Jugosllavia. Takimi i parë i Grave të Ballkanit për Paqe u mbajt në dhjetor të vitit 1999 në Rojamont (Royaumont), Francë. Ky ishte takimi i parë i grave pas përfundimit të luftës

¹⁷ Shih <http://www.transeuropeennes.org>

në Kosovë 1998-1999. I vendosur brenda kornizës së gjerë *Transeuropéennes* për përkthimin kulturor dhe kritikën e përjashtueshmërisë dhe dhunës së bazuar në identitet kombëtar, takimi në Rojamont Gratë e Ballkanit për Paqe foli për kufijtë: fizikë, simbolikë, psikologjikë dhe në çfarëdo forme tjetër që i ndan bashkësitë. Prandaj, duke u përpjekur që të nxisë kulturën e dialogut dhe të mendimit kritik përmes perspektivës gjinore dhe të grave për paqen dhe pajtimin, takimi në Rojamont shërbeu si platformë për bashkësi të grave në Ballkan. Konferenca u quajt “Aktivistet për konflikte: perspektiva demokratike për Ballkan”. Ky rrjet ishte kolektiv unik politik me vizion të paqes dhe të drejtësisë sociale në Ballkan. Gratë e Ballkanit për Paqe kanë qenë shprehje e rezistencës së diskurseve nacionaliste dhe thellimit të fragmentimit dhe ndarjes shoqërore në Ballkan. Pas takimit në Rojamont, aktivistet në prill të vitit 2000 përsëri u tubuan në Mavrovë, në ish-Republikën Jugosllave në Maqedoni (tani Maqedonia Veriore). Në takimin në Mavrovë, u bisedua për ballafaqimin me presionin e bashkësisë.

Gratë e Ballkanit për Paqe vendosën vizionin e vet, parimet dhe përkushtimin në deklaratat në Rojamont dhe në Mavrovë të cilat gjithashtu shërbyen si platformë për veprim. Deklarata e Mavrovës, e cila u nënshkrua më 30 prill të vitit 2000, thekson se edhe përkundër “proceseve të fragmentimit brenda dhe midis shoqërive ballkanike, si edhe presioneve të ndryshme me të cilët disa individë ballafaqohen, edhe nga perspektiva e rezistencës, aktivistet, dallojnë përgjegjësinë individuale si hap të domosdoshëm ndaj rimarrjes së rrezikut të ballafaqimit me realitetin tonë personal dhe me realitetin e të tjerëve; e zhvillojnë rrjetin e solidariteti brenda të cilit do ta mbështesin njëra tjetrën në rimarrjen e këtyre rreziqeve; duke hyrë në sferën dhe dukshmërinë publike; dhe duke i kaluar edhe kufijtë simbolik edhe territorial.”¹⁸ Siç u theksua më tutje në Deklaratën nga Mavrova, Gratë e Ballkanit për Paqe kanë qenë të orientuara për “mbizotërimin e presioneve të dukshme dhe të padukshme të bashkësisë të cilat shkakto-

¹⁸ Deklarata e Mavrovës (The Mavrovo Declaration, 2000).

jnë frikë, e të cilat i mohojnë vendimet individuale; hapja e hapësirës për të tjerë; të përmbajturit nga të gjykuarit e përvojave të të tjerëve, ku frika dhe dhembja e të tjerëve nuk vihet në pyetje; dhe për ndërtimin e besimit dhe rikrijimin e hapësirës për komunikim dhe lëvizje. ”¹⁹ Më tutje, u propozua tubimi i aksioneve specifike të cilat e nënkuptojnë “ mbështetjen në burime lokale dhe rajonale; aksionet e kalimit të kufijve, paqja dhe arsimi për gjininë brenda rrjetit të organizatave jodeveritare të shteteve të ndryshme; sensibilizimi gjinor i elektoratit; trajnimi i politikanëve për veprim politik në bazë të kartës së dakorduar; cilatdo veprime dhe të gjitha veprimet e tjera të cilat janë vegla qytetare që i kundërshtojnë bashkësitë e armatosura, dhe të cilat e përfshijnë shkrimin, mësimin, takimet, udhëtimet, ngritjen e vetëdijes.”²⁰ Që t’i bëjmë të dukshme aktivistet Gratë e Ballkanit për Paqe dhe nënshkrueset e Deklaratës së Mavrovës, këtu po e japim tërë listën me emrat e tyre:

¹⁹ Ibid.

²⁰ Ibid.

Sevim Arbana (Tiranë)
Nazlie Bala (Prishtinë)
Elsa Ballauri (Tiranë)
Teuta Barbullushi (Tiranë)
Mirjana Barbulović (Nish)
Bilana Bejkova (Shkup)
Sonja Biserko (Beograd)
Eli Bojaxhieska (Shkup)
Antigona Bucaj (Prishtinë)
Diana Culi (Tiranë)
Aida Qorović (Pazar i Ri)
Korala Dilić (Zagreb)
Neli Dimc (Lubjanë)
Aleksandra Dukovska (Shkup)
Rreze Duli (Prishtinë)
Jagoda Gajić (Mali Loshinj)
Avdiije Gashi (Prishtinë)
Bojana Genov (Mali Loshinj)
Anka Gogić-Mitić (Pozharevc)
Brankica Grupković (Beograd)
Milica Gudović (Beograd)
Meliha Hubić (Zenicë)
Tanja Ignjatović (Beograd)
Merita Ilo (Tiranë)
Sllavica Inxhevska (Shkup)
Rada Iveković (Paris)
Jovanka Ivković (Banja Llukë)
Edit Jankov (Novi Sad)
Spasijka Jovanova (Shkup)
Natasha Kandić (Beograd)

Kosovare Kelmendi (Prishtinë)
Katarina Kolozova (Shkup)
Elife Krasniqi (Prishtinë)
Florina Krasniqi (Prishtinë)
Vjollca Krasniqi (Prishtinë)
Katarina Kruhonja (Osijek)
Nada Ler Sofroniq (Sarajevë)
Sandra Lubinkoviq (Beograd)
Iris Luarasi (Tiranë)
Natasha Megjedoviq (Nikshiq)
Briseida Mema (Tiranë)
Azbiya Memedova (Shkup)
Jadranka Miliqeviq (Sarajevë)
Lepa Mlagjenoviq (Beograd)
Biserka Momçinoviq (Poreç)
Nazmie Pacolli (Shkup)
Nela Pamukoviq (Zagreb)
Milica Paniq (Uzhicë)
Zharana Papiq (Beograd)
Erika Papp (Suboticë)
Borka Paviqeviq (Beograd)
Tanja Renex (Lubjanë)
Valida Repovac (Sarajevë)
Zibija Sharenkapiq (Pazar i Ri)
Maria Savovska (Shkup)
Arbnore Shehu (Prizren)
Zana Shuterqi (Tiranë)
Svetlana Slapsak (Lubjanë)
Sonja Staniq (Osijek)
Mariana Stankoviq (Bijelinë)

Sabina Stopinsek (Lubjanë)
Teodora Tabački (Beograd)
Milka Tadiq (Podgoricë)
Radojka Tomasheviq (Split)
Gordana Vidoviq (Modriçë)
Jadranka Vojiçiq (Podgoricë)
Bilana Zekoviq (Podgoricë)
Jasna Zhivkoviq (Kralevë)
Arlinda Zylali (Tetovë)

Siç u theksua në deklaratë, Gratë e Ballkanit për Paqe dhanë shembull të solidaritetit dhe të veprimit të përbashkët që të përballonin pengesat dhe kufijtë e komunikimit dhe bashkëpunimit ndëretnik. Ky përkushtim në praktikë u zbatua përmes ndërhyrjes në projektin me titull “Karvani i grave për paqe”, që u mbajt më 25 maj deri më 9 qershor të vitit 2002. Dyzet e katër aktiviste me vendosmëri i kaluan kufijtë: e vjetër dhe të porsakrijuar ose imagjinarë, midis shteteve, bashkësive, gjuhëve, si edhe në ëndrrat e Ballkanit. Qëllimet kryesore të “Karvanit të Grave për Paqe” ishin “ballafaqimi i ndërsjellë me realitetin, ndriçimi i së vërtetës për lufërat dhe përgjegjësia për dhunë lufte, si edhe përkrahja

e ndërsjellë në luftën kundër presi- 59
onit të përditshëm të bashkësisë.”²¹
Karvani i vizitoi gratë në “ vendet e
dhembjes”, bashkësitë e veçuara, bi-
sedoi me gratë në hapësirat e shpresës
dhe të angazhimit qytetar, i vizitoi
vendet përkujtimore dhe mori pjesë në
biseda me krijuesit e politikës. Me
kalimin e kufijve fizikë midis shte-
teve dhe bashkësive nga Sllovenia deri
në Shqipëri, “Karvani i Grave për Paqe”
tregon potencialin e aktivizmit të
grave dhe politikës që bashkon iden-
titete, kujtime dhe drejtësi duke kër-
kuar paqen në shoqëritë në pas-luftë.

*Gjykata e Grave për
ish-Jugosllavi:*

*Kërkimi i drejtësisë, të vërtetat
dhe kujtesa aktive*²²

Luftërat në ish-Jugosllavi – gjatë vi-
teve të 90-ta të shekullit të kaluar
– nxitën shkatërrim masiv të jetëve,
dhunës, dhembje dhe vuajtje. Si gjeog-

²¹ <http://www.transeuropeennes.org>

²² Ky tekst mund të gjendet në https://www.zenskisud.org/en/pdf/Vjollca_Krasniqi_eng.pdf.

rafi e dhunës, këto luftëra e paraqitën përvojën e mbijetuar të shumë grave dhe burrave në mjedise të ndryshme të ish-Jugosllavisë. Edhe përkundër humbjeve të njerëzve, një gjeografi të tillë disa e shohin si epizodë historike të një të kaluare. Për shumë të tjera, të kujtuarit e krimeve, masakrave, dëbimeve, shpërnguljes me dhunë, dhunës seksuale dhe shkatërrimit të pronës, është vazhdimisht i pranishëm - i mishëruar në personalitetin e tyre dhe i gdhendur në kujtesë. Mirëpo, lufta dhe kujtesa nuk është simbol i vetëm në kohën e sotme. Kjo është edhe etje për drejtësinë e të mbijetuarëve.

Si mekanizma të drejtësisë, tribunali dhe gjykimet për krime të luftës janë të rëndësishme për t'u dhënë fund krimeve në luftë. Qasjet reparuese të drejtësisë gjithashtu janë të rëndësishme, jo vetëm për shkak se përfshijnë një numër të madh të njerëzve, por edhe për shkak se përfshijnë të kujtuarit, komemoracionin dhe paraqitjen publik të vuajtjes dhe humbjes. Edhe të gjitha këto elemente, mund të pohohet, i kontribuojnë shërimit, dhe janë parakusht për ardhmëri pa dhunë.

Gjykata për Gra për ish-Jugosllavi – të cilin e inicoi lëvizja(et) e grave në shtetet pas-jugosllave (Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia) – ishte në vitin 2015 në Sarajevë. Kjo është Gjykata e Parë e Grave në Evropë. Ishte kjo ndërhyrje feministe në drejtësinë riparuese. Në këtë betejë për drejtësi dhe të vërtetën, Gjykata e Grave e kundërshtoi harresën e dhunës në luftëra në ish-Jugosllavi, të cilën e zbatuan më shumë sisteme kriminale, me aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë të cilët vepruan kundër popullsisë civile, veçanërisht grave. Gjykata e grave merret me vetëdijen publike, etikën dhe moralitetin lidhur me humbjet në njerëz. Motivi themelor politik ka qenë që të sigurohet që e kaluara nuk do të përsëritet. Gjykata u përpoq që të tregojë lidhjen midis individit dhe kolektivit në përvojat e luftës dhe të dhunës; që të problematizojë rreziqet në bartjen e traumave në gjeneratën e ardhshme, dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, të theksojë rëndësinë e të kujtuarit që një dhunë e tillë të mos përsëritet më në të kaluarën.

E bazuar në konceptualizimet feministe të drejtësisë, përgjegjësisë dhe kujdesit si themel i paqes së përhershme, Gjykata e Grave ofroi hapësirë publike në të cilën mund të dëgjohej zëri i grave. Ky ishte vend ku gratë mund të paraqitnin përvojat e veta të padrejtësisë të shkaktuara nga lufta, dhembjet dhe vuajtjet e përhershme, si edhe rezistencën e vet ndaj luftës dhe aktivizmin për paqe. Për shkak të kësaj politika e Gjykatës së Grave ka të bëjë me gratë të cilat kanë mbijetuar. Ai e kundërshton metanarracionin e grave si viktimë, sepse kur një narrativ i tillë ideohet dhe aplikohet, ai gruan e lë pa kurrfarë veprimi. Struktura e Gjykatës së Grave u përbë nga paneli prej pesë temave gjerësisht të përkufizuara dhe formës së dhunës të cilën e përjetuan gratë. E përfshin dhunën ndaj civilëve, dhunën seksuale, dhunën ekonomike, dhunën militariste, dhe dhunën etnike.

Në Gjykatën e Grave, që u mbajt në Qendrën për Kulturore Boshnjak në Sarajevë, gratë të cilat kanë përjetuar dhunë lufte e zunë vendin qendror. Biseduan me qindra gra të cilat qëndronin në qetësi, dëgjonin me kujdes

dhe shpesh flisnin me lotë për gratë nga vendi siç janë Srebrenica, Drenica, Krusha e Madhe, Deçani, Vukovari, të përmendim vetëm disa, e kujtonin dhunën e luftës që e përjetuan, anëtarët e familjes të cilët e humbën jetën në luftëra, të jetëve të shkatërruara dhe të shpresave të humbura, por edhe betejat për drejtësi dhe strategji të cilat i aplikuan që t'i rikonstruktonin jetët e veta. Mirëpo, dëshmitaret, nuk ishin vetëm. Atyre iu bashkuan edhe aktivistet dhe mediatorët e Gjykatës së Grave të cilat e shprehën solidaritetin dhe e analizuan kontekstin e gjerë shoqëror dhe politik të luftërave në ish-Jugosllavi para kolegjit gjyqësor dhe publikut.

Më shumë se 50 gra folën për përvojat e veta personale dhe për dhunën të cilën e përjetuan. Dhuna të cilën e përshkruan është më e ndërlikuar se ajo që është konceptuar në legjisllacionin tradicional. Dëshmitë e tyre janë individuale, por i tregojnë metodat e dhunës të cilat ishin të institucionalizuara dhe ishin pjesë e ekonomisë politike të luftës dhe sistemit të kriminalitetit i cili përfshiu

aktorët e shumëfishtë: forcat ushtarake dhe policore të shtetit, forcat paramilitare, mercenarët dhe mafitë, por me kufij të paqartë të angazhimit, të orientuar në radhë të parë ndaj popullsisë civile: grave, fëmijëve, djemve dhe personave më të moshuar.

Gjykata e Grave ishte ndërhyrje për drejtësi, të vërtetën dhe kundër harresës së luftës dhe pasojave të luftës ndaj jetës së grave dhe bashkësive të tyre. Përveç kësaj, ai kontribuoi që të pranohet mbijetesa e grave dhe të kuptuarit e shtuar të shumkuptimshëm të dhunës së luftës si kategori e caktuar gjinore. Tri ditë derisa dëshmuan ato treguan që për dëshimitare humbja dhe dhembja nuk mund të maten, por që e kanë mpshtur me luftën e tyre për drejtësi, duke i kujtuar në mënyrë aktive dhe duke luftuar kundër kulturës së mosdënimit. Ato luftojnë për ripërtëritjen e jetëve të veta, jetëve të familjeve të veta dhe bashkësive të veta. Gjithashtu, ato të palodhura kërkojnë drejtësinë. Në Gykatën për Gra dëshmitaret edhe njëherë bënë qartë se lufta për drejtësi dhe paqe duhet të vazhdojë.

*Edhe një rrëfim për gratë në
Kosovë në socializëm:
Zona e hirtë midis*

65

Historia e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë gjatë kohës së socializmit, pas shpërbërjes së shtetit socialist, në vitet e 1990-ta dhe pas luftës 1998-1999 në Kosovë, përgjithësisht la pasdore historinë shoqërore, dhe veçanërisht historinë e grave. Historia dhe pasqyrimet e ngjarjeve janë caktuar sipas gjinisë, kurse gratë mezi u reprezentuan në një referencë. Ndërhyrjet në studime të historisë të cilat i bënë shkencëtarët feministe në qendër i vënë aktorët shoqërorë përmes historisë gojore dhe intervistat biografike të cilat tregojnë se si sistemet makro dhe përvojat personale të njerëzve në jetën e përditshme preken dhe përafrohen. Një pasqyrim i tillë është edhe rrëfimi jetësor i Didare Gjorgjeviqit nga Prizreni, e cila pas Luftës së Dytë Botërore, në erën e re të socializmit në Kosovë, e braktisi mënyrën tradicionale të jetës, u bë mësuese dhe e pranoi politikën emancipuese të cilën socializmi në atë kohë e ofroi në ish-Jugosllavinë socialiste dhe në Kosovë.

Socializmi ishte projekt modernist, kurse arsimi pati rol në modernizimin e tij. Shtetet socialiste ua mundësuan grave që të paraqiten në tregun e punës, edhe pse gratë paguheshin në grupe me pagesa më të ulëta të vep- rimitarive dhe profesioneve.²³ Integrimi i grave në tregun e punës u bazua në përkufizimet binare të feminitetit dhe maskulitetit. Edhe pse socializmi konsiderohej më egalitar dhe më emancipues për gra, shteti socialist dhe ideolog- jitë socialiste nuk e shlyen simbolin e amësisë si detyrë shoqërore dhe kombë- tare.²⁴ Patriarkati mbeti tejet i rrën- josur në strukturën shoqërore. Mirëpo, gratë i ofruan rezistencë patriarkatit madje edhe me çmim që të përjashtohes- hin nga familja dhe bashkësia. Siç tha Didara, duke iu referuar jetës së vet, patriarkati nuk e mbështeti fjalën e grave, as të drejtën për zgjedhje per- sonale.²⁵ Didara jetoj dhe u bëri re-

²³ Shih Julie Mertus, gjendet në gjuhën angleze, "Hu- man Rights of Women in Central and Eastern Europe", *Journal of Gender, Social Policy and the Law*, Vëll. 6 (2): 369-484, 1998.

²⁴ Rada Iveković and Julie Mostov, *From Gender to Na- tion*, Ravenna: Longo, 2002.

²⁵ Miroslava Malesević, *Didara: Životna prica jedne Prizrenke*, Beograd: Srpski Genealoški Centar, 2004, 65.

zistencë kornizave dhe kufijve të cilët 67
ia kufizonin hapësirën në të cilën do
të dëgjohej zëri i saj dhe i cili ia
kufizoi të drejtën për liri të zgje-
dhjes. Rrëfimi i saj jetësor flet për
emancipimn e grave në kohën socialis-
te, duke ofruar pikëpamje në përvojat
e grave në jetën e përditshme. Mirëpo,
rrëfimi i saj gjithashtu e bën të mun-
dur që të kuptohen marrëdhëniet shumë
kuptimëshe, por të përkohshme gjinore
pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë.
Rrëfimi i Didares flet për lirimin e
grave dhe për rezistencën e saj per-
sonale duke anuluar kufijtë simbolikë
dhe materialë të cilët i mbështetin
ideologjitë kombëtare, religjioni dhe
formacionet kulturore. Përveç kësaj,
ajo flet për subjektivitetin e ri të
grave i cili u gjenerua në Kosovë gjatë
socializmit. Siç pohon Elife Krasniqi,
Didara ofron kundër-narracion “periu-
dhë në të cilën çdo gjë ishte e ndarë
sipas linjave etnike, dhe çdo gjë ish-
te e thjeshtësuar në terma zi/bardhë,
kurse rrëfimi i Didares tregon zonën e
hirtë në mes.”²⁶

²⁶ Elife Krasniqi, “Didarja: Një Rrëfim i Munguar” [Didara: A Missing Narrative]. Gjendet në <https://kosovotwopointzero.com/didarja-nje-rrrefim-i-munguar>.

Arti si aktivizëm: Puna individuale e artisteve në Kosovë dhe në Serbi

Artistet në Kosovë dhe në Serbi luajtën rol të rëndësishëm në agazhimin e artit në luftën kundër luftës, nacionalizmit, për drejtësi dhe të drejta të njeriut. Kjo pjesë e tregon punën e tri artisteve: Sarandë Bogujevcit, Milica Tomiqit dhe Flakë Halitit. Puna e tyre u formua në pikëtakimin e artit si angazhim politik i cili merret me temën e luftës, nacionalizmit, drejtësisë pas luftës, kujtesat dhe etikën. Tri ndërhyrje artistike të cilat këtu i zgjodhëm Bogujevci, Tomiq dhe Haliti janë politike dhe të angazhuara dhe flasin për luftën dhe për krimet e luftës, por edhe për proceset e dështuara të pajtimit dhe ndërtimit të paqes të cilët edhe më tutje po i mbajnë në jetë të gjitha konfliktet kombëtare dhe shoqërore.

Projekti artistik i Sarandë Bogujevcit “Bogujevci: historia vizuale” flet për humbjen dhe mbijetesën e familjes së saj në luftën në Kosovë 1998-1999.²⁷

²⁷ Shih dëshmimi me gojë i Sarandë Bogujevcit në <http://oralhistorykosovo.org/saranda-bogujevci/>

Ky projekt artistik tregon për 69 rrëfimin personal për krimet e luftës ndaj familjes së saj, kur 14 pjesëtarë të familjes Bogujevci i vrau grupi paramilitar “ Shkorpioni”, në mesin e tyre pesë fëmijë. Saranda e cila në atë kohë ishte 13 vjeçare, Jehona 11 dhe Fatosi 12, të cilët gjithashtu kanë qenë pjesë e ekspozitës si artistë, të cilët mbijetuan. Ky është rrëfim për tragjedinë personale dhe humbjen e familjes në luftë ku autorët e bartin narracionin personal të përvojës së vet dhe mbijetesës. Ky punim u shpreh nderime viktimave të civile të luftës dhe është vend i kërimit të drejtësisë, por edhe dëshmon se drejtësia është e arritshme. Ekspozita në Beograd shkaktoi shqetësime të shumta të cilat rezultuan me dhunë dhe ekspozita është dashur të mbyllet.

Ndërhyrja artistike me titull *XY Rikonstruktimi i krimit: sfidë e amnezisë e Milica Tomiqit* merret me politikën e kujtesës. Ajo e problematizon amnezinë duke gjurmuar hapësirat paranoike të cilat e rrethojnë identitetin kombëtar dhe që mbahen bashkë me ndihmën e ideologjisë nacionaliste dhe ndjenjave. Si

kritikë e nacionalizmit dhe projektit përjashtues të kombit, ajo përpiqet të ndërtojë subjektin etik i cili është i aftë të mbajë mend dhe të kujtojë duke vë në pyetje luftën, harresën, frikën nga të që qenët më ndryshe, dhe ksenofobinë. Kjo në fakt është kritikë e kombit dhe e amnezisë kolektive. Gjithashtu ky punim e problematizon përdorimin dhe kuptimin e shumëfishtë të nocionit të pajtimit në diskursin politik, në nivel institucional, të artit dhe në jetën e përditshme. Ky punim i destabilizon kategoritë përjashtuese të identitetit dhe shenjuesit të cilët i formëson heshtja. Punimi i Milica Tomiqit i përqan zonat e shoqërizimit që kanë rënë në harresë dhe që kundërshtojnë kujtesën. Për Milica arti nuk mund të dështojë kujtesën, sepse të mbajturit mend i bën krimet e luftës të dukshme dhe në këtë mënyrë e ofron mundësinë që të arrihet drejtësia. Kështu, arti është i orientuar në të mbajturit mend aktiv, në kërkimin e drejtësisë dhe dukshmërinë politike dhe mund të hapë hapësirë të veprimit që të rishqyrtohen proceset, simbolet, imagjinata dhe praktikat institucionale të ndërtimit të kombit.

Punimi i Flakë Halitit *Vdekja jonë, 71 darka e tyre* shtron pyetjen e etikës së përfaqësimit të viktimave të dhunës së luftës në projektet artistike. Me theks në viktima dhe në persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovë 1998-1999., Flaka Haliti pyet: “a është etike të përdoren viktimat si koncept për vepër artisitke, dhe ku është kufiri i një keqpërdorimi të tillë në këtë rast dhe në rastet e tjera të punës artistike?” Kjo është ndërhyrje e rëndësishme e cila i thekson rrezidet e përvetësimit politik të kësaj përvoje në shërbim të narrativave politike. Ky punim i kritikon narrativat kombëtarë për statusin vetjak të viktimës që në mënyrë tematike lidhen për identitet, emocion dhe kulturë. Duke iu referuar metaforës “vdekja jonë, darka e tyre”, Flaka Haliti i orienton artistët dhe publikun për rrëfimet të cilat vetë viktimat i konstuktojnë për jetën e vet dhe kështu kërkojnë mjete të reja që t’u shmangen rreziqeve (ri)viktimizimit në/përmes ndërhyrjes artistike. Aq më parë, punimi i Flakë Halitit e destabilizon tropin e viktimave jashtë artit, në politikë dhe në media. Në raportimin e mediave në

konfliktin në Kosovë, gjuha e flijimit mbizotëroi në përshkrimet e përvojave të luftës dhe në Kosovë edhe në Serbi.

Narratizimi i aktivizmit të grave në Kosovë dhe në Serbi

Hulumtimi feminist flet për rrëfimin e ngjarjeve të grumbulluara, rrëfimeve dhe kujtimeve, si dhe për gjetjen e mënyrës sipas së cilës ata e kanë formuar historinë e së sotmes. Studimi i feminizmit(zmave) gjatë kohës nuk duhet domosdoshmërisht ta orientojë vëmendjen në të gjitha ndërhyrjet feministe në të cilat kemi dëshmuar, kemi dëgjuar dhe i kemi përjetuar. Përdërisa angazhohemi rreth teksteve dhe praktikave të përfshira në politikën e përditshme të gjeneratës së saj, gjithashtu punohet edhe për trashëgiminë dhe kujtimet e mëparshme në to. Mirëpo, ky studim, nuk është përpjekje e rikonstruktimit të historiografisë së feminizmit dhe lëvizjes së grave në Kosovë dhe në Serbi në të kaluarën dhe në të tashmen. Në vend të saj, fjala është për ndërhyrjen e cila përpiqet të theksojë fluiditetin historik të

marrëdhëniet kohore dhe hapësinore – 73
si ide, të teorisë dhe politikës – dhe
të tregojë mënyrat në të cilat ka bërë
jehonë në narrativat dhe modelet e an-
gazhimit të grave gjatë viteve 1990
dhe më vonë.

Lufta/luftërat në vitin 1990 në ish-Ju-
gosllavi kanë pasur vulë të përherëshme
dhe e kanë formuar lëvizjen feministe
dhe identifikimet feministe. Ashtu siç
theksoi Dubravka Žarkov, feministet
“kanë qenë të parat të cilat e kanë
shqyrtuar se si shpërbërja e Jugoslla-
visë dhe ndarjet kanë ndikuar në iden-
titetet e tyre dhe çfarë ishte lufta
për to personalisht dhe për aktivizmin
e tyre.”²⁸ Lufta si përvojë fizike dhe
emocionale është e përcaktuar sipas
gjinisë. Konflikti i përcaktuar si-
pas gjinisë ka ndikim të madh dhe të
përherëshëm ndaj veprimit të grave dhe
ndaj identiteteve. “Meta-narracionet
mbizotëruese” të konflikteve jugosl-
lave e kanë bërë veprimin e grave dhe
rezistencën ndaj luftës dhe naciona-
lizmit më të marginalizuar. Vërtet,

²⁸ Dubravka Žarkov, “Feminism and the Disintegration of Yugoslavia: On the Politics of Gender and Ethnicity,” *Social Development Issues*, Vëll. 24, No. 3 (2003), 3.

aktivizmi feministe kundër luftës në hapësirat pas-jugosllave mbeti terren i pa hulumtuar. Kritika e narrativit të caktuar sipas gjinisë në luftërat jugosllave kështu ofron mundësi për përshkrimin e veprimit të grave përmes ndarjes kombëtare dhe solidaritetin e vazhdueshëm feminist në të tashmen. Hartëzimi i angazhimit të grave dhe i aktivizmit politik në Kosovë i destabilizon narrativat e gjinisë dhe marginalizimin e grave në shprehjet historike të socializmit, post-socializmit, luftës dhe ripërtëritjes në pas luftës. Pra, duke i shqyrtuar hapësirat pas-jugosllave si shprehje të dallimeve dhe të qenët më ndryshe gjithashtu po përpiqemi të regjistrojmë dhe të bëjmë më të dukshëm solidaritetin dhe potencialet për transformimet gjinore transnacionale.

Raporti midis identitetit kombëtar dhe solidariteti të grave i përcolli lëvizjet e grave në të gjitha hapësirat postjugosllave. Në fakt, rezistenca kundër luftës me vete tërhoqi forma të ndërlikuara të lidhshmërisë qytetare dhe solidaritetit midis grupeve feministe. Veprimi i grave u shpreh në

mënyra të ndryshme dhe në momente të 75
ndryshme në të cilat vendoset lidhja
midis grave në hapësirat postjugos-
llave dhe në nivel ndërkombëtar. Në
hapësirat postjugosllave feminizmi e
formoi rezistencën ndaj luftës dhe na-
cionalizmit. Siç pohoi Xhil Benderli
(Jill Benderly):

Solidariteti i grave mbi dhe jashtë
identitetit kombëtar e bëri femi-
nizmin lëvizje mjaft unike shoqëro-
re në periudhën në të cilën shumica
e lëvizjeve, në nivele të ndryshme,
u bënë të nacionalizuara që në vi-
tin 1991.²⁹

Po përpiqemi të kuptojmë veprimin e
grave në ndërlikueshmëritë e vet,
sfidat dhe potencialet e bazuara në
betejën feministe gjatë luftës. Për
këtë arsye propozojmë që njohuria
të vendoset në praktika specifike të
cilat flasin për solidaritetin e grave
dhe depërtimin e kufijve: fizikë, sim-
bolikë, emocionalë dhe imagjinarë.
Pra, i vështrojmë kampet e refugjatëve
në Maqedoni gjatë luftës në Kosovë.

²⁹ Benderli, citat në Zharkov 2003

Kampet e refugjatëve nuk janë veçuar që të jenë hapësira të organizimit dhe solidaritetit të grave. Kampet e refugjatëve ofrojnë vend për leximin e dinamikës hapësinoro-kohore të veprimit të grave në Kosovë dhe në rajon. Përveç kësaj, veprimi i grave dhe solidariteti gjatë luftës janë kundër temave dhe pasqyrimeve të përsëritura me narracion të përcaktuar gjinor të luftës dhe nacionalizmit në hapësirat pas-jugosllave.

Kampin e përdorim si paradigmë të gjendjes së njeriut, jetës lakuriq, që të huazojmë shenjusin e Gjorgje Agambenit (Giorgio Agamben) *homo sacer*-it si produkt i fuqisë sovrane. Pohojmë që jo vetëm kampi i refugjatëve si kufizim i veçantë në hapësirë dhe në kohë, por edhe hapësira në përgjithësi, e bart kuptimin politik dhe potencialin për veprim. Kampet e refugjatëve në Maqedoni 1999 hapën mundësi dhe potenciale të reja për veprimin e grave. Në kampe të refugjatëve, gratë e Kosovës u mbështetën në gjeografinë e solidaritetit dhe të mbështetjes. Përveç kësaj, përvoja dhe organizata e refugjatëve në kampe krijuan identi-

tet të veçantë të relacionit dhe për- 77
kufizimin e vetë aktivisteve. Në këtë
moment “shumë aktiviste e kthyen iden-
titetin e vet të aktivisteve përmes
përkrahjes së aktivisteve të tjera dhe
punës së tyre në kampet e përqendri-
mit.”³⁰

Siç pohon Dejvid Harvi (David Harvey),
“vendet... gjithnjë varen nga proce-
set e relacionit të cilat i krijojnë,
mbajnë dhe i tretin.”³¹ Veprimi i grave
në luftë dhe i kampeve të refugjatëve
në Maqedoni flet për krijimin e veprimi
të përforcuar historik që i trans-
formon kufijtë. Siç theksoi Svetlana
Slapšak “disa tregime për gra qartë i
kufizojnë hapësirat e grave si liminale
dhe periferë.”³² Në fakt, në kampe të
refugjatëve aktivistet krijuan ambien-
te të sigurta që gratë refugjate të

³⁰ Nicole Fransworth, *History Is Herstory Too*, Prishtinë: Kosovar Gender Studies Centre. Prishtinë: Kosovar Gender Studies Centre, 2008, 149.

³¹ David Harvey, *Cosmopolitanism and the Geographies of Freedom*, New York: Columbia University Press, 2009, 190.

³² Svetlana Slapšak, “Theorizing Women’s Mobility in the Balkans,” in *Gender and Identity: Theories from and/or on Southeastern Europe*, Beograd: Women’s Studies and Gender Research Center, 2006.

munden t'i ndajnë përvojat e veta dhe të gjejnë përkrahjen e grave të tjera³³

Nga ana tjetër, feministet në Beograd e përhapën solidaritetin ndaj grave nga Kosova. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s filluan të dokumentojnë ndjenjën e frikës së “grave në Prishtinë dhe në pjesët e tjera të Kosovës të cilat jetuan në frikë ekstreme, terror dhe dhembje.”³⁴ I thirrën gratë nga Kosova dhe vazhduan t'i vizitojnë gratë nga Kosova të cilat u bënë refugjate në Maqedoni. Në kampe të refugjatëve në Maqedoni, u përpoqën të dëshmonin çfarë krejt përjetuan ato gra.

Solidariteti ka qenë koncept i rëndësishëm në mobilizimin politik feminist të hapësirës pas-jugosllave. Duke u mbështetur në përkufzimin e feminizmit si projekt politik i orientuar për transformimin e marrëdhënieve hierarkike të pushtetit, Lepa Mlagjenović e përkufizon solidaritetin e grave si akt i cili

³³ Fransworth, 2008, 155.

³⁴ Žarana Papić, “Kosovo War, Feminist Politics and Fascism in Serbia,” Beograd Women’s Studies Centre, 1999.

Paraqitet pas vendimit që të dëgjo- 79
het Tjetra, të dëgjohet përvoja e
saj, të lejohet që rrëfimi i saj të
manifestohet derisa ajo të më flasë
për të. Kjo e nënkupton se pajtohem
se secila përvojë e një gruaje është
njësoj e vlefshme. Sa vetja ime
është e rëndësishme për mua, dhe që
edhe gratë e tjera janë të rëndë-
sishme.³⁵

Njohja intersubjektive është veçori
kryesore e solidariteti në këtë ras-
te. Ky përkufizim ka për qëllim kul-
tivimin e interesit aktiv për gratë
nga ana tjetër, duke u përpjekur që ta
transformojë të menduarit dhe ekono-
mitë ekzistuese të cilat i kultivojnë
ndarjet mbajtjen e kufijve. Gjithsesi,
bashkëpunimi me Tjetrin/Tjetrën është
proces politik, e jo shprehje e ngjas-
hmërisë dhe/ose dallimit. Kjo e nën-
kupton solidaritetin i cili përpiqet
të konfirmojë përvojën e secilës gru-
aje dhe ta anulojë hierarkinë gjinore,
etnike dhe racore. Solidariteti është

³⁵ Lepa Mladjenović, Politika Ženske Solidarnosti [Wo-
men's Politics of Solidarity], gjendet në <http://www.mreza-mira.net/vijesti/aktivnosti-mreze/lepa-mladje-novic-politika-zenske-solidarnosti>.

të akt politik. Anulimi i hierarkisë ua mundëson grave që të veprojnë dhe ofron mundësi për politikë transformuese në drejtim të drejtësisë. Për këtë arsye Çandra Talpade Mohanti (Chandra Talpade Mohanty) deklarohet për “politikë të angazhimit, e jo për politikë të transcendencës.”³⁶

Solidariteti i grave gjatë luftës në Kosovë 1998-1999 gjithashtu flet për tendosjet midis paradigmes së dallimeve dhe të qenët më ndryshe në teoretizimin feminist. Përderisa paradigma e dallimit synon “që të vërë gratë në qendër”, përkundër kësaj, paradigma e të qenët më ndryshe synon që “të dekonstruktojë qendrat”. Megjithatë, përkushtimi i vëmendjes dallimeve gjinore nuk e vendos këtë dallim si tregues të inferioritetit, por barazisë dhe procesit reciprok të konstituimit të subjektit. Kjo është ndërlikueshmëri e rëndësishme e subjektivitetit dhe veprimit politik. Solidariteti edhe përkundër dallimit gjithashtu është edhe raport etik brenda kolektivitetit

³⁶ Chandra Talpade Mohanty, *Feminism without Borders: Decolonizing Theory, Practicing Solidarity*, Durham: Duke University Press, 2003.

të supozuar “ne”. Njëmend, solidariteti mund të fillojë me ndjenjat. Më tutje, ajo zgjerohet në proces të takimit edhe përkundër dallimeve kombëtare. 81

Ngjashëm me nocionin “mestize” të Glorije Anzaldue (Gloria Anzaldúa)³⁷, feministet në hapësirat postjugosllave e përdorën simbolin e kufirit si simbol i ndarjes, në të njëjtën kohë duke e riformuluar përmes aktivisteve të vetëcaktuara të cilat i tejkalojnë kufijtë. Kështu aktivistja, si aktiviste e dhembjes së Tjetrit/Tjetrës, është e barabartë me dëshmitaren si aktore politike. Mirëpo, duam të theksojmë “rëndësinë e kohësisë dhe radhitjen e veprimit në marrëdhëniet midis aktorëve gjatë konstruksionit të kuptimit.”³⁸ Marrëdhëniet hapësinore dhe dialogjet jashtë kufijve, siç janë takimet sy me sy në mes të luftës, nuk e kanë përfshtirë vetëm përshkrimin e përvojave, por edhe ekzaminimin se si ato ndikuan në vetë identitetin e dëshmitareve. Ky solidaritet politik u krijua nga procesi

³⁷ Gloria E. Anzaldúa, *Borderlands/La Frontera: The New Mestiza*, San Francisco, CA: Spinsters/Aunt Lute, 1987.

³⁸ Sylvia Walby, *Crises*, Cambridge: Polity Press, 2017, 17.

i negocimit për politikën e dallimeve. Gjithsesi, kjo praktikë feministe e bën të mundur të kuptuarit lidhur me faktin se si gërshetohet me vendosjen e identitetit të aktivisteve.

Përcaktimi i vendndodjes përmes të menduarit për dallimet është me rëndësi për politikë transformuese feministe dhe përvojën e ardhshme e aktivisteve. Për këtë dëshmon solidariteti feminist në hapësirën postjugosllave. Përvojat aktiviste të grave i përcollën përsiatjet e nocioneve të dallimit që e formuan solidaritetin feminist në nivel lokal dhe rajonal. Terreni i veprimit të grave ishte i ndërlikuar dhe ekzistonte në grupe dhe bashkësi të ndryshme brenda shoqërisë civile që krijoheshin në hapësirën postjugosllave. Duke theksuar dallimin midis këtyre grupeve, Lepa Mladjenović theksoi se “dallimi kryesor midis organizatave joqeveritare për të drejta të njeriut dhe organizatave qeveritare feministe është fakti që feministet kanë insistuar në etikën e dallimit.”³⁹

³⁹ Lepa Mladjenović, “Notes of a Feminist Lesbian during Wartime,” *European Women’s Studies Journal*, Vol. 8, No. 3, (2001), 386.

Veprimi i grave gjatë luftës me siguri ka qenë vend për histori opozitare dhe kujtime lidhur me luftën dhe me praktikën gjinore të luftës dhe efektet e saj ndaj trupit, kulturës dhe politikës. Solidariteti feminist e ka nënkuptuar jo vetëm përcaktimin e vendndodhjes, por edhe kundërshtimin e ristrukturimit hierarkik të dallimeve gjinore brenda ideologjive nacionaliste. Siç theksoi Ana Mishkovska Kajevska, “duke folur për ‘tejkalimin e kufijve’ ose ‘kalimin e vijave’, feministet e kanë theksuar vazhdimin e tyre tejet të guximshëm përmes linjave të porsaformuara etnike dhe shtetërore të caktimit të kufijve.”⁴⁰ Kjo është shprehje e veprimit politik në kuptimin më të mirë. Solidaritetin feminist në luftë në hapësirën pas-jugosllave ndoshta më së miri e ka shpjeguar Çandra Talpade Mohanti me fjalët, që

uniteti i grave si gra më së miri kuptohet jo si diçka e *dhënë*, në bazë të bashkësisë natyrore/psikologjike; kjo është diçka për

⁴⁰ Ana Miškovska Kajevska, *Feminism at War: Belgrade and Zagreb in the 1990s*, New York: Routledge, 2017, 8.

çfarë duhet të punohet, të luftohet
- në histori.⁴¹

Shënim përfundimtar për ardhmërinë e përbashkët emancipuese

Gjatë dekadave të kaluara të periudhës pas-jugosllave, vëllimi në rritje i punës për feminizëm dhe gjini dukshëm u shpreh në aksione të numërta dhe të llojllojshme të grave, në njohuri dhe krijimtari kulturore të cilën politika e rezistencës dhe emancipimit e ka formuar në fund të shekullit, XX dhe dy dekada të shek, XXI. Megjithatë, specifike për hapësirën e shoqërisë pas-jugosllave, trajtimi i disa shteteve ndaj lëvizjeve të grave dhe organizatave ka tendencë ta lërë anash këtë hapësirë si nyje të nostalgjisë dhe humbjes, që njëkohësisht është edhe nyje me përplot potencial për ekzaminimin e kriterëve të origjinalitetit në ideologjitë dominuese etnocent-

Shënime mbi aktivizmin e grave dhe politikën feministe në pas-Jugosllavi

⁴¹ Chandra Talpade Mohanty, "Feminist Encounter: Locating the Politics of Experience" in Anne Phillips, *Feminism and Politics*, Oxford: Oxford University Press, 1998, 264.

rike, post-transicion/neoliberales dhe mizogjene, në këtë zonë të përhershme të pandërprerë, joqetësuese gjeopolitike të paretisë. Çështjet feministe, të grave dhe gjinore e shqetësojnë dhe i tronditin paragjykimet e rrënjësura dhe qëndrimin konformist, por nuk ofrojnë kurrfarë garancish në krahasim me rezultatit e politikës transformative. Ky studim ka për qëllim të ofrojë informacione lidhur me çështjen se në çfarë mase angazhimi i grave dhe feminist manifestohet dhe merr pjesë në ndryshimet shoqërore dhe në krijimin e njohurive në periudha të ekzistimit, anulimit dhe suprimimit të Jugosllavisë në hartën gjeopolitike të së sotmes? Përgjigjja do të ishte që në këtë moment historik rasti shihet në potencialin prodhues të aksioneve të angazhuara feministe dhe të grave të cilat e kultivojnë njohurinë kritike, kulturore dhe politikën shoqërore transformuese rreth problemeve të përbashkëta dhe në kërkim të modeleve emancipuese të cilat i fillojnë ndryshimet shoqërore në drejtim të atyre më të drejta, por që është më e rëndësishme, në drejtim të përbashkët.

Hulumtimet e reja në fushën e cila e ndryshon politikën e lëvizjeve shoqërore dhe politikën e krijimit kulturor dhe krijimit të njohurive e ofrojnë vizionin i cili ka për qëllim që të tejkalojë gjendjen e zhgënjimit dhe të dëshpërimit, gjë që shumë femine dhe aktiviste, aktore, punëtore të kulturës dhe shkencëtare e kanë ndjerë pas luftërave të viteve të 90-ta. Në këtë vizion, rrjetet afektive të marrëdhënieve personale edhe më tutje po e luajnë rolin e shquar në gjetjen e rrugëve alternative për shqyrtim për politikën emancipuese në aksionin feminist, teori dhe në kritikën shoqërore. Këto marrëdhënie personale në kurrfarë mënyre nuk krijojnë strehim të fshehtë të sigurt, por janë nxitje për zhvillimin e mënyrave të bashkëpunimit për të menduar për të vërtetat e përbashkëta dhe për ardhmëri, dhe të ndërmarrin hapat konkretë në vendosjen dhe promovimin e strategjive të reja të rezistencës, por edhe mënyrat më të sofistikuar, neoliberales të përsëritjes së përhershme të patriarkatit, konfliktit, krizave dhe mekanizmave të tjerë hegjemonistë të cilët i mbajnë në jetë marrëdhëniet e pabara-

barta të pushtetit. Këto marrëdhënie 87
personale aktiviste gjithashtu janë
“qeliza epistemologjike”, të lëvizshme
dhe teknologjike të cilat krijohen me
politikën e miqësisë dhe të mendimit
kritik.

Një sërë intervistash me gratë të ci-
lat janë shoqërisht të angazhuara në
politikë dhe kulturë në këtë proces
të përhershëm dhe mjaft të rëndë të
transformimit shoqëror emancipues në
hapësirën jugosllave dhe pas-ugosllave
japin një shikim të vlefshëm në pozi-
tat e tyre të ndryshme. Pozicionet e
ndryshme të cilat i mbajnë gratë janë
bazë e përbashkët feminste për vep-
rim, mendim dhe jetë të përbashkët,
por na bëjnë më të vetëdijshme për ve-
çantitë lokale dhe solidaritetin mbi
të gjitha dallimet. Si të tilla, ato i
bëjnë ballë qëndrimit të depolitizu-
ar të politikës multikulturaliste dhe
ofrojnë platformë për krijim teorik
dhe praktika të rrënjosura në lokale,
por të krahasueshme me kontekstet e të
tjera. Me vendosjen e çështjeve femi-
niste dhe të grave, të arriturave dhe
betejës, të gjitha gratë përmes jetë-
ve të veta, punës dhe veprimit kanë

treguar se nuk është me rëndësi se sa vështirë është të jeshë në pozitë të rëndë dhe jo të favorizuar, por kanë treguar se për emancipim, liri dhe solidaritet vlen të jetohet dhe të luftohet. Për të gjitha ato, qëllimi është i qartë: shoqëria shoqërisht, politikisht, ekonomisht dhe kulturallisht e lirë, pa klasa dhe e barabartë për të gjithë. Nga ky moment (viti 2019) po bëhet e qartë se diagnoza shoqërore e historisë së të tanishmes në hapësirën pas-jugosllave kërkon kontinuitet me feminizmat e ndryshëm (post)jugosllavë të cilët e kanë fijen e njëjtë ideologjike të kuqe të lirisë dhe të drejtësisë sociale. Nga e kaluara gjithashtu shihet qartë se gratë në socializëm kanë pasur më së shumti dobi nga angazhimi i femrave dhe nga beteja, por fatkeqësisht jo gjatë. Të gjitha këto refleksione aktiviste, kulturore, teorike ndaj politikës emancipuese të proceseve konkrete materiale, si të gjitha kërkesat e vetëdijshme feministe në aspektin social, sot duhet të jenë të lidhura për të tjerët, të ngjashme me praktikën e së tashmes, por gjithashtu në mënyrë ndërkombëtare konfrontohen me

përvetësimin e ardhshëm neoliberal të feminizmit dhe lëvizjeve të tij gjë që jep një pasqyrim të realitetit të rremë në të cilin gratë e kanë vulnetin e lirë që ta zgjedhin mënyrën sipas së cilës duan të jetojnë; mbrojtjen institucionale, juridike dhe mënyrat e tjera që të mbrohen. Në të njëjtën kohë, kjo pamje premtuese e fsheh rritjen e dhunës në të gjitha nivelet: strukturore, familjare, seksuale dhe simbolike.

Duke përdorur burimet analitike të cilat ofrojnë studimet aktuale shoqërore dhe politike për politikën transformuese dhe shembujt e studimeve kulturore dhe gjinore, ky hulumtim tregon disa shënime të vlefshme për aksionet shoqërisht të angazhuara të grave dhe për strategjitë politike feministe të cilat insistojnë në politikën e barazisë dhe angazhohen për imagjinariume të përbashkëta shoqëro-politike dhe kulturore. Duke folur përgjithësisht, në prapavijë të studimit qëndron kritika materialiste/feministe e cila ia kushton vëmendjen kontekstit historik dhe vendosjes teorike; të përkushtuarit politik; analizën diskursive dhe

ripërkufizimin e temës. Të udhëhequr me përvojën paraprake hulumtuese dhe me rezultatet, si autore të studimit, e kemi pasur ndërmend të nisemi nga hulumtimi i cili do ta lexojë të kaluarën në kundërshtim nga interpretimet dominuese: “t’ua shtojë zërat e atyre që nuk gëzojnë të drejta, të zbulojmë fajin e errësimit të thellë të vetëdijes së ngarkuar politike, të thellojmë dhe ta zgjerojmë gabimin në dhënien e legjitimitetit të status quos.”⁴² Vlera e një kritike të këtillë materialiste qëndron në aftësinë e saj që të ndihmojë në shqyrtimin e “dukurisë së përbashkët të forcave kulturore, vartëse, reziduale, krijuese, alternative dhe kundërshtare ndaj forcave mbizotëruese, me të cilat gjenden në marrëdhënie të ndryshme të inkorporimit, negocimit dhe rezistencës.”⁴³

Në fund, kjo betejë e përbashkët e grave sot përfshin të gjithë narrativat e së kaluarës dhe e mbështet

⁴² Kiernan Ryan, *New Historicism and Cultural Materialism: A Reader*. Londër, Arnold., 1996, XV.

⁴³ Alan Sinfield, *Faultlines: Cultural Materialism and the Politics of Dissident Reading*, Oxford, Clarendon Press. 1992, 9.

qëndrimin specifik dhe të bazuar sipas subjektiviteteve individuale të cilët kolektivisht janë të lidhura dhe të orientuara nga jashtë me konceptin e “qëndrueshmërisë”. Duke e përcjellë Rozi Brajdotin (Rosi Braidotti), e përfaqësojmë rivendosjen e subjektit në ndjenjën materialisht të përputhur të përgjegjësisë dhe përgjegjësisë etike për shoqëri dhe ambient përreth të bazuar në tërë njohurinë paraprake dhe në përvoja të cilat i kemi pasur si feminsite (pas)jugosllave përmes së kaluarës mjaft turbulente. Si “ alternativë të procesit të përgjithshëm të shtrembërimit që do të ishte më vonë në rritje e sipër të dallimeve sasiore, e jo zhvendosje cilësore e hiperindividualizimit”, ta huazojmë ripërkufizimin e subjektit politik të Rozi Brajdotit, po krijohen lëvizjet e qëndrueshme ose ndryshimet me origjinë nga subjektet nomade në rezistencën e tyre aktive ndaj rrezikut që të futen në realizimin e të qenit të tyre personal më ndryshe. Ajo që është më e rëndësishme për këtë koncept “të krijimit” është “që korniza e tyre kohore gjithnjë është ardhmëria para ardhmërisë, gjë që domethënë, lidhsh-

mëria përmes së sotmes dhe së kaluares në aktin e ndërtimit dhe aktualizimit të ardhmërive të mundshme.”⁴⁴ Kurse ardhmëria jonë, siç kanë rënë dakord të gjithë ata të cilët morën pjesë në intervista dhe biseda të këtij studimi, shkon në drejtim të idesë së vjetër të përbashkët femniste, në aspektin social të shoqërisë së barabartë, të drejtë dhe humane.

Shënime mbi aktivizmin e grave dhe politikën femniste në pas-Jugosllavi

⁴⁴ Rosi Braidotti, *Transpositions: On Nomadic Ethics*. Cambridge and Malden, MA: Polity, 2006, 137.

Bibliografia

Agamben, G. *Homo Sacer: Sovereign Power and Bare Life*, Stanford California: California University Press, 1998.

Anzaldúa, G. E. *Borderlands/La Frontera: The New Mestiza*, San Francisco, CA: Spinsters/Aunt Lute. 1987

Benderly, J. "Rape, feminism and nationalism in the war in Yugoslav successor states". Në Lois A. West (ed.) *Feminist nationalism*, Londër: Routledge, 1997, 59-72.

Braidotti, R. *Transpositions: On Nomadic Ethics*. Cambridge and Malden, MA: Polity, 2006.

Howard, C. *Civil Resistance in Kosovo*, Londën: Pluto Press, 2000.

Davis, A.Y. *The Meaning of Freedom: And Other Difficult Dialogues*. San Francisco: City Light Books, 2012.

Dimitrijević, O. & Pelević. M. *Freedom: The Most Expensive Capitalist Word*. Belgrade: Bitef Production, 2016, gjendet në <http://festival.bitef.rs/event/freedom-expensive-capitalist-word/>.

Douglas, M. *Purity and Danger: An Analysis of Concepts of Pollution and Taboo*. Londër, UK: Routledge, 1966.

Foucault, M. *Society Must Be Defended: Lectures at the Collège de France, 1975-1976*. New York, NY: Picador, 2003.

Foucault, M. *The Birth of Biopolitics*. New York: Palgrave Macmillan, 2008.

Foucault, M. *Society Must Be Defended: Lectures at the Collège de France, 1975-1976*, New York, NY: Picador, 1992.

Fransworth, N. *History is Herstory Too*, 95
Prishtinë: Kosovar Gender Studies Centre, 2008.

Gržinić, M. "From Biopolitics to Necropolitics and the Institution of Contemporary Art", *Pavilion, Journal for Politics and Culture*, No.14 (2010), 9-94.

Harvey, D. *Cosmopolitanism and the Geographies of Freedom*, New York: Columbia University Press, 2009.

Hass, C. "Qu'appelle-t-on une guerre? Enquête sur le nom de guerre aujourd'hui." PH.D. dissertation, *Université Paris 8*, Paris, 2001.

Herscher, A. & Rieldmayer, A. *The Destruction of Cultural Heritage in Kosovo*, Cambridge: Kosovo Cultural Heritage Survey, 2001.

Human Rights Watch *Under Order: War Crimes in Kosova*, gjendet në <http://www.hrw.org/reports/2001/kosovo>.

Husanović, J. "Feminističke ekskurzije, transverzalnosti, traverzije: o punoljetnim iskustvima solidarnosti i zajedništva u proizvodnji znanja i emancipativnoj politici". Në: *Feminizam - politika jednakosti za sve*. Jelena Petrović and Damir Arsenijević (eds.), Beograd: *ProFemina*, 2011.

Iveković, R. & Mostov, J. *From gender to nation*, Ravenna: Longo, 2002.

Kajevska, Miskovska, A. *Feminism at War: Belgrade and Zagreb in the 1990s*, New York: Routledge, 2017.

Krasniqi, E. "Didarja: Një Rrëfim i Munguar" [Didara: A Missing Narrative], gjendet në

<https://kosovotwopointzero.com/didarja-n-je-rrefim-i-munguar>.

Kristeva, J. *Powers of Horror: An Essay on Abjection*. New York: Columbia University Press, 1982.

Malesević, M. *Didara: Zivotna prica jed-ne Prizrenke*, Beograd: Srpski Genealoski Centar, 2004.

Marx, K. *Capital, Volume 3*. New York: Penguin Books, 1981.

Marx, K. *Capital, Volume 1*. New York: Penguin Books, 1976.

Mbembe, A. "Necropolitics". Translated by Libby Meintjes. *Public Culture* 15, No. 1 (2003), 11-40.

Mertus, J. "Human Rights of Women in Central and Eastern Europe", *Journal of Gender, Social Policy and the Law*, Vëll. 6. No.2 (1998), 369-484.

Mladjenović, L. "Notes of a Feminist Lesbian during Wartime", *European Women's Studies Journal*, Vol. 8, Vëll. 3 (2001), 381-391.

Mladjenović, L. *Politika Ženske Solidarnosti [Women's Politics of Solidarity]*, gjen-det në <http://www.mreza-mira.net/vijesti/aktivnosti-mreze/lepa-mladjenovic-politika-zenske-solidarnosti>.

Mohanty, T. Ch. *Feminism Without Borders: Decolonizing Theory, Practicing Solidarity*, Durham: Duke University Press, 2003.

Mohanty, T. Ch. "Feminist Encounter: Locating the Politics of Experience". Në Anne Phillips (1998) *Feminism and Politics*,

Oxford: Oxford University Press, 1998, 97
254-272.

Papić, Ž. "Kosovo War, Feminist Politics and Fascism in Serbia", Beograd: Women's Studies Centre, 1999.

Petrović, J. "What Does the Freedom Stand for Today?" In: *Border Thinking*, Marina Gržinić (ed.), Berlin: Stenberg Press and the Academy of Fine Arts Vienna, 2018, 108-122.

Ryan, K. *New Historicism and Cultural Materialism: A Reader*. London, Arnold.1996.

Sinfield, A. *Faultlines: Cultural Materialism and the Politics of Dissident Reading*. Oxford, Clarendon Press. 1992.

Slapšak, S. "Theorizing Women's Mobility in the Balkans", in *Gender and Identity: Theories from and/or on Southeastern Europe*, Beograd: Women's Studies and Gender Research Center, 2006

The Mavrovo Declaration gjendet në http://www.transeuropeennes.org/en/articles/91/The_Mavrovo_Declaration.html

Walby, S. *Crises*, Cambridge: Polity Press, 2017.

Žarkov, D. "Feminism and the Disintegration of Yugoslavia: On the Politics of Gender and Ethnicity", *Social Development Issues*, Vëll. 24, No.3 (2003), 1-19.

Burimet nga interneti

www.z2ogalleria.it/1/wp-content/uploads/2012/01/Milica_Tomic1.pdf

<http://www.seecult.org/vest/bogujevci-vizuelna-istorija>

http://www.transeuropeennes.org/en/37/the_women_caravan.html

http://www.memory-culture-art.org/artists/flaka_haliti.html

<http://www.zenskisud.org/en/>

Biografi të shkurtra
të autorëve

Dr. Vjollca Krasniqi është sociologe. Ligjëron në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Ka doktoruar në Universitetin e Lubjanës dhe ka magjistruar me temën “Gjinia, zhvillimi dhe globalizimi” në Shkollën për Ekonomi dhe shkenca politike në Londër (LSE), dhe ka një diplomë bachelor për filozofi dhe sociologji në Universitetin e Prishtinës. Interesimet e saj hulumtuese janë barazia gjinore, kujtesa kombëtare dhe kolektive, ndërtimi i shtetit, ndërtimi i paqes dhe rimëkëmbja e pasluftës. Ka botuar një numër punimesh, kapituj librash dhe raporte për këto çështje, duke përfshirë: Kornizat e luftës së drejtë: mediat dhe diskursi politik në Kosovë gjatë gjyqimit të Haradinajt në Gjykatën Penale për Drejtësi si aktorë të ndryshimeve të brendshme: ndikimi ndaj kornizave të mediave, që e botoi K. Bachmann et al. (2018); Topografia e ndërtimit të kombit në Kosovë në strategjitë e ndërtimit të kombit simbolik në Evropën Juglindore, e përgatiti P. Kolsto (2014); Tjetër raport për banalitetin e së keqes: politika kulturore e gjyqimit të Milosheviqit në Kosovë, në gjykimin e Milosheviqit:

Një autopsi, e botoi T. Vaters (2013), 101 dhe Imazhi, gjinia dhe pushteti: Politika e përfaqësimit në Kosovën e pasluftës në vështrimin feminist (2007).

Dr. Jelena Petroviq është studiuese feministe, autore dhe teoreticiene e artit. Drejtuese e hulumtimeve të projektit (PI). Gjeografitë artistike: Politika e përkatësisë në Institutin për teori dhe art dhe studime të kulturës, në Akademinë e arteve figurative në Vjenë (i financuar nga Fondi austriak për shkencë FVF përmes programit Elise Richter 2019/2023). Bashkëautore e teksteve, ngjarjeve, ekspozitave dhe projekteve lidhur me temat (post)jugosllave - veçanërisht në lidhje me historinë shoqërore, teorinë e artit dhe feminizmit. Doktoroi në ISH - Fakultetin e Shkencave Humaniste në Lubjanë (2009). Nga viti 2008 deri më 2014 ishte anëtare grupit të ri teorik jugosllav në Grupin Përmendolja. Në vitin 2011 u bë bashkëthemeluese dhe anëtare e kolektivit feminist kurator Red Min (e)d (www.redmined.org). Si nismëtare e kursit Arkivi i gjallë: drejtuese feminist dhe prak-

tikat bashkëkohore artistike ligjëroi në Akademinë e Arteve Figurative dhe Dizajnit në Universitetin e Lubjanës (2014-2017). Nga viti 2015 deri më 2017 u emërua profesoreshë për historinë e artit në Evropën Qendrore dhe Juglindore në Akademinë e Arteve Figurative në Vjenë. Palgrave Macmillan e botoi librin e saj Autorësia e grave në Jugosllavinë e ndërluftës: Politika e dashurisë dhe luftës 2019.

Dr. Dubravka Stojanović është historiane dhe profesoreshë në Katedrën e historisë së përgjithshme bashkëkohore në Universitetin e Beogradit. Punoi në çështjet e demokratizimit në Serbi dhe në Ballkan në fund të shek. 19 dhe në fillim të shek. 20, me interpretimet e historisë në librat e rinj në gjuhën serbe, në historinë sociale, procesin e modernizmit dhe historinë e grave në Serbi. Ajo është këshilltare e të dërguarit të veçantë për të drejta të njeriut e Kombeve të Bashkuara në fushën e kulturës dhe arsimit. Ka marrë pjesë në mjaft konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe ka mbajtur ligjërata në Sorbonë, në Universitetin Kolumbia, në Universitetin Stanford, Universi-

tetin Humbolt, Universitetin e Lub-103
janës, Zagrebit, Sarajevës, Athinës,
Sofjes, Kopenhagës, etj. Me Milan Ris-
toviqin e botoi vjetarin e historisë
sociale. Është nënkryetare e Komite-
tit ballkanik për arsim në fushën e
historisë të cilin e organizon Qendra
për Demokraci dhe Pajtim në Evropën
Juglindore, Selanik , Greqi. Botoi 9
libra, duke përfshirë edhe librin për
historinë botërore: Ngritja e botës
globale 1885-2015. Për librin Serbia
dhe demokracia: 1903-1914 ka marrë
çmimin e Qytetit të Beogradit për sh-
kenca shoqërore dhe humane për vitin
2003. Qendra për paqe dhe zhvillim të
demokracisë e vlerësoi me çmimin për
paqe në vitin 2011, për angazhimin e
saj paqesor të cilin e filloi në vitin
1993, lufta në ish-Jugosllavi. Në vi-
tin 2012 mori çmimin për fitoren e li-
risë që jepet për gra të cilat merren
me aktivizmin e të drejtave të nje-
riut. Fitoi dekoratën franceze Che-
valier de l'Ordre national du Mérite
(Kalorëse e urdhërit kombëtar të nde-
rit).

БЕЛЕШКЕ О (ПОСТ)ЈУГОСЛОВЕНСКОМ ЖЕНСКОМ
АКТИВИЗМУ И ФЕМИНИСТИЧКИМ ПОЛИТИКАМА
Изворно дело: *Notes on Post-Yugoslav Women's
Activism and Feminist Politics*

Издавач:

Фондација Јелена Шантић

Војводе Шупљикца 11а

11000 Београд, Србија

www.fjs.org.rs

За издавача:

Ирина Љубић

Уводни текст:

Дубравка Симојановић

Ауторке студије:

Вјолца Краснићи и Јелена Пејровић

Дизајн:

Јана Оршолић

Превод на српски и лектура:

Тијана Парезановић и Милан Марковић

Превод на албански:

Наиџе Маџа Имами

Штампа: Алџа Нова, Београд

Примерака: 300

Овај документ је део пројекта „Хероине мира –
Приче изван њрећоварацкој сјола“, који је
финансијски подржан од стране Балканског фонда
за демократију Немачког Маршаловог фонда
Сједињених Држава. Мишљења изражена у овој
публикацији не представљају ставове Балканског
фонда за демократију, Немачког Маршаловог фонда
Сједињених Држава, или њихових партнера.

B | T | D

The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND